



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raport i Vlerësimit Institucional i
Universitetit Marin Barleti**

Dhjetor 2016

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	4
Gjykim i përmbledhur	5
Raport i detajuar	6
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	6
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	11
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	16
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	20
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	24

Rreth këtij vlerësimi

Ky vlerësim institucional ka për qëllim të përgjithshëm të kontrollojë dhe vlerësojë, për secilin prej IAL-ve, shkallën e përmbushjes së standardeve shtetërore shqiptare të cilësisë, të hyra në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi institucional i jashtëm është një proces këqyrje, kontrolli dhe vlerësimi nga ekspertë të jashtëm. Secili grup vlerësimi përbëhet nga ekspertë nga Mbretëria e Bashkuar, të përzgjedhur dhe caktuar nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (QAA-UK), dhe ekspertë shqiptarë, të përzgjedhur dhe caktuar nga Agjencia Publike Shqiptare e Akreditimit për Arsimin e Lartë (APAAL). Grupi i vlerësimi të jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-UK.

Raportet e përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, në bazë të shkallës që IAL-ja përmbush standardet, por edhe për informimin e IAL-ve, Qeverisë Shqiptare, publikut dhe studentëve mbi shkallën që IAL-ja përmbush standardet. Ky raport ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë çështjet me përparësi për përmirësim (procesi përmes të cilit ofruesit e arsimit të lartë përmirësojnë sistematikisht cilësinë e shërbimit dhe mënyrat si ata i mbështetin studentët për të nxënë).

Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë janë grupuar në pesë fusha vlerësimi: Organizimi i institucionit dhe menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe studentët e mbështetja e tyre. Ky raport nxjerr në pah karakteristikat e praktikave të mira, jep rekomandime, konfirmon veprimet në proces dhe paraqet dobësitë për çdo fushë vlerësimi, së bashku me një gjykim se në çfarë shkalle IAL-ja përmbush standardet. Ekspertët mund të japin këto gjykime: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur në pjesën më të madhe; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk përmbushen.

Në fund, ekspertët dalim me një rekomandim, në formën e një gjykimi të përmbledhur, drejtuar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it. Ky gjykim i përmbledhur mund të jetë një nga shkallët e më poshtme:

- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur plotësisht**
- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet shtetërore të cilësisë nuk janë përmbushur.**

Gjatë procesit të hartimit të raportit, QAA-UK ofroi ekspertizën e saj duke siguruar që grupi i ekspertëve të mbështesë konkluzionet e tij në evidenca. Gjithashtu ajo dha ndihmesën e saj duke redaktuar dhe hartuar përmbledhjen e raportit të plotë të dhënë më poshtë.

Grupi i vlerësimit të jashtëm

Znj. Mandy Hobart
Profesor Jeremy Bradshaw
Dr. Gjergj Thomai

Kryetare
Anëtar
Anëtar

Nënshkrimi
Nënshkrimi
Nënshkrimi

Konteksti i këtij vlerësimi

Shkolla e Lartë jo publike "Universiteti Marin Barleti" ose IAL "Universiteti Marin Barleti" (UMB) është një institucion arsimor privat që ndodhet në Tiranë, Shqipëri. Institucioni u themelua në vitin 2005 si një shkollë jo-publike e arsimit të lartë dhe në vitin 2009 ka marrë miratimin nga Këshilli i Ministrave për të ofruar diploma Master. Në vitin 2012, Institucioni iu miratua nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e drejta për të organizuar një cikël të tretë "Doktoraturë në Studime Ndërkombëtare për Familjen dhe Komunitetin", të njohur nga Universiteti Klemson (Clemson University). Universiteti me shërbimet e tij nxit një qasje humaniste, në përputhje me misionin e tij, që është të përgatisë studentët të përmbushin qëllimet e tyre profesionale në dobi të komuniteteve ku ata punojnë dhe jetojnë.

Universiteti përbëhet nga dy fakultete, Fakulteti i Drejtësisë, Shkencave Sociale dhe Politike, dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë, së bashku me tre institute kërkimore, dhe ofron 20 programe studimi të ciklit të parë dhe programe studimi të ciklit të dytë dhe të tretë. Në vitin akademik 2015-16, institucioni kishte 1,062 studentë të regjistruar në programet e tij me kohë të plotë dhe të pjesshme.

Ky institucion është IAL-ja e parë në Shqipëri që ofron strukturë me programe parësore dhe dytësore, duke ofruar një gamë të gjerë zgjedhje të kualifikimeve, duke filluar nga certifikatat deri tek diplomat. Programet përfshijnë kualifikime të ciklit të parë dhe të dytë në fusha si teknologjia e informacionit, biznes, marketing, biznes ndërkombëtar, marrëdhënie ndërkombëtare, menaxhim, administrim publik, anglisht dhe psikologji sociale. Gjithashtu, ofrohen një larmi kualifikimesh të zhvillimit profesional për të mbështetur të nxënit gjatë gjithë jetës në biznes dhe në komunitetin profesional. Marrëveshje bashkëpunimi janë lidhur me një sërë universitetesh perëndimore në Evropë dhe në SHBA, dhe ofrohen programe shkëmbimi me universitetet e Barit dhe Romës.

Raport i përmbledhur

SHLUJ Universiteti Marin Barletit (UMB) është një IAL privat që ndodhet në Tiranë, i cili ofron programe universitare të ciklit të parë dhe të dytë që mbahen në gjuhën shqipe, si dhe ofron një program doktrate, të ciklit të tretë, në gjuhën angleze, të njohur dhe ofruar nga Universiteti Klemson në SHBA. IAL-ja ka dy fakultete dhe ofron mësimin në dy ambiente, secili me mjediset e veta, përfshirë bibliotekën, laboratorët dhe klasa moderne e të mirëmbajtura. Misioni i UMB-së është të përgatisë studentët të realizojnë qëllimet e tyre profesionale dhe të ndjekin interesat e tyre në dobi të komunitetit. UMB-ja është gjithashtu i lidhur me katedra ndërkombëtare, përfshirë katedrën Xhan Mone (Jean Monnet) dhe katedrën e UNESCO-s, të cilat i ofrojnë institucionit mundësi angazhimi në kërkime sociale dhe shkencore. Në vitin 2015-16, UMB-ja kishte 1,062 studentë të regjistruar në programet e ciklit të parë dhe të dytë.

Një ekip i IAL-së, i përbërë nga staf drejtues, akademik dhe mbështetës dhe një përfaqësues të studentëve, hartuan një raport vetëvlerësimi. Projektraporti iu shpërnda një audience më të gjerë për të marrë mendime përpara se raporti të përfundohej dhe miratohej nga Rektori.

Më 22 dhe 23 shtator 2016, u zhvilluan vizita e vlerësimit në këtë IAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të njohur të arsimit të lartë nga Mbretëria e Bashkuar dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga një institucion shqiptar. Agjencia Publike e Akreditimit për Arsimin e Lartë (APAAL) vuri në dispozicion, për të ndihmuar grupin e vlerësimit, Menaxherin e Vlerësimit dhe një sekretar për të mbajtur shënime. Tetë javë përpara vizitës së inspektimit, grupit të vlerësimit iu vu në dispozicion raporti i vetëvlerësimit dhe portofoli i evidencave mbështetëse, që më pas u plotësuan nga dokumentacioni shtesë i kërkuar nga vetë grupi. Gjithsej u morën në shqyrtim 79 dokumente. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, grupi i vlerësimit u njoh me strukturën, politikën, procedurat e administrimit dhe natyrën e veprimtarisë mësimore dhe kërkuese të ndërmarrë nga IAL-ja. Provat shkresore të marra në shqyrtim nga grupi përfshinin Statutin e Institucionit, Rregulloret akademike, Raportet Vjetore, Politikën e Pranimeve, listën e marrëveshjeve dhe memorandumet me jashtë, listën e projekteve kërkimore, shembuj të informacionit të programit dhe evidenca të mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së inspektimit, u zhvilluan një sërë takimesh që i dhanë grupit të vlerësimit mundësinë të kuptojë më qartë përgjegjësitë, procedurat dhe pikëpamjet e stafit dhe studentëve. Grupi zhvilloi takime me rektorin, drejtues të lartë, studentë, lektorë dhe personel administrativ e mbështetës, si dhe partnerë të jashtëm dhe punëdhënësit. Gjatë të gjitha takimeve, u mbajt procesverbal konstatimi si burim referimi dhe prove vetëm për grupin e vlerësimit. Grupi i vlerësimit bëri gjithashtu një vizitë në kampus. Këqyri bibliotekat, mjediset e mësimdhënies, laboratorët dhe zyrat, si dhe pa një demonstrim të sistemeve të informacionit në internet dhe elektronike të Institucionit. Pasi morri në shqyrtim të gjitha evidencat e disponueshme, ekipi arriti në përfundimet e paraqitura më poshtë.

Ky IAL përmbush standardet e menaxhimit dhe organizimit. Ka strukturë të qartë vendimmarrëse dhe mbikëqyr e vlerëson performancën në nivel fakulteti dhe institucioni, gjë që mbështet organizimin efikas të programeve, përfshirë këtu edhe përdorimin e informacionit të marrë përmes bashkëpunimeve. Qasja sistematike e Institucionit për t'iu përgjigjur çështjeve të ngritura nga proceset e cilësisë, dhe përdorimi i bashkëpunimeve si mënyrë për t'iu dhënë të diplomuarve mundësi për kryerjen e praktikave dhe ofrimi i praktikave, si dhe për t'i ndihmuar ata në zhvillimin e aftësive, njohurive dhe botëkuptimit të nevojshëm për punësimin e ardhshëm, u vlerësuan si praktikë e mirë. Senati dhe Rektori punojnë për të garantuar që zhvillimi institucional të planifikohet dhe zbatohet me kujdes, dhe që bashkëpunimet me jashtë dhe studimi i tregut të përdoren si bazë për hartimin e ofertës së programit.

Administrimi efikas i burimeve, në përmbushje të standardeve, u evidentua përmes menaxhimit transparent të burimeve njerëzore, procedurave të qarta për menaxhimin financiar në përputhje me kërkesat ligjore dhe futjen e sistemeve elektronike për menaxhimin e informacionit, gjë që mundëson gjurmimin e të dhënave të studentëve. Ambientet janë të një standardi të mirë dhe në përputhje si me nevojat e programit ashtu edhe me standardet e detyrueshme. Cilësia e ambienteve akademike dhe sportive, sistemet e përmirësuar të intranetit, ofrimi i ndihmesës falas për nxënësit e shkollave të mesme në përgatitjen për provimet përfundimtare, përbëjnë një praktikë të mirë. Zhvillimi i mëtejshëm i bibliotekës duke rritur numrin e librave në dispozicion do të përmirësonte më tej shërbimin.

Kurrikula është e atillë që nxit të nxënit gjatë gjithë jetës në përputhje me misionin e Institucionit, dhe studentët përfitojnë nga një sërë mundësish për praktika dhe sistemim në punë. Zhvillimi i aftësive që lidhen me punësimin, së bashku me një sërë mundësish të vazhdueshme të zhvillimit profesional paraqesin praktikë të mirë në mbështetjen e profesionistëve që punojnë në një sërë sektorësh. Bashkëpunimi me punëdhënësit si bazë për zhvillimin e kurrikulave, dhe sistemet e reja të informimit në internet që kryejnë analizën efikase të të dhënave të studentëve, mbeten fusha që kërkojnë akoma punë të vazhdueshme për të siguruar përmbushjen e standardeve të cilësisë.

Aktualisht institucioni ka sisteme efikase për menaxhimin e mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit dhe kërkimit, të cilët përmbushin standardet e cilësisë. Qasja gjithëpërfshirëse e përdorur për rishikimin e shërbimit të ofruar çdo vit dhe për të ndjekur fushat e identifikuar për zhvillim, është një praktikë e mirë. Zhvillimi i stafit dhe ofrimi i ndihmesës për stafin dhe studentët me qëllim angazhimin në projekte me jashtë, u konstatuan si praktika të mira.

Studentët mbështeten mjaft mirë për t'u përfshirë në veprimtari akademike, sportive dhe kulturore. Si praktika të mira u konstatuan edhe orientimi i studentëve për t'u regjistruar në universitet, klube sportive dhe sociale, si dhe përdorimi i mendimeve dhe këshillimeve me studentët si bazë për përmirësimin e mëtejshëm. Shkalla e informimit, këshillimit dhe udhëzimeve që u ofrohen studentëve për të rritur dhe nxitur punësimin e tyre, praktikë kjo që zbatohet edhe për të diplomuarit, janë të një rëndësie të veçantë. Zhvillimi i vazhdueshëm i burimeve të bibliotekave dhe forumeve në internet do të mbështesnin më tej angazhimin e studentëve.

Grupi vlerësues arriti në përfundimin se ky universitet përmbush plotësisht standardet e cilësisë në të pesta fushat kyçe të Mbuluara.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi praktikat e mira me karakteristikat e mëposhtme:

- Qasja sistematike e UMB-së si kundërpërgjigje ndaj problemeve të ngritura nga proceset e cilësisë përmes hartimit dhe zbatimit të planeve të veprimit (pika 1.8)
- Përdorimi i bashkëpunimeve dhe kërkimi i tregut, si bazë për mbledhjen e informacionit, është një praktikë që ndihmon Institucionin të nxjerrë të diplomuar me aftësi, njohuri dhe botëkuptim të përshtatshëm (pika 1.11)
- Standardi i lartë i pajisjeve në të gjitha fushat e mësimdhënies iu krijon studentëve një ambient të nxëni me cilësi të lartë (pika 2.9)
- Ambientet sportive mbështesin në mënyrë efikase programet sportive, veprimtaritë jashtëshkollore dhe, në mbrëmje, ofrojnë edhe ambiente për komunitetin (pika 2.9)
- Ndihmesa dhe mbështetja falas për nxënësit e shkollave të mesme të vitit të fundit për t'u përgatitur për provimet dhe përparimin e tyre në arsimin e lartë (pika 2.11)
- Qasja e UMB-ja ndaj të nxënit gjatë gjithë jetës, gjë që promovohet duke përfshirë në programet e studimit edhe module të lëndëve dytësore-plotësuese, për të siguruar zhvillimin e vazhdueshëm profesional (pika 3.4)
- Menaxhimi i stazheve dhe ofrimi i praktikave i studentëve përkrah në mënyrë efikase zhvillimin e njohurive bazuar në praktikë (pika 3.10)
- Sisteme të qarta dhe gjithëpërfshirëse për rishikimin vjetor të programeve dhe ndjekjen e veprimeve kryesore (pika 4.1)
- Qasja sistematike e UMB-së për zhvillimin e stafit motivon stafin të angazhohet në trajnime dhe mundësi nga jashtë (pika 4.6)
- Mbështetja gjithëpërfshirëse që i ofrohet stafit akademik për të lehtësuar përfshirjen në projekte me financim të jashtëm dhe përfshirjen e studentëve në veprimtari të lidhura me to (pika 4.10)
- Programi i qartë i orientimit ndihmon studentët të kuptojnë gamën e udhëzimeve dhe këshillave në dispozicion (pika 5.5)
- Këshillimi me studentët shërben si informacion bazë për rishikimin dhe përmirësimet vjetore (pika 5.8)

- Gama e klubeve dhe veprimtarive në dispozicion të studentëve, përfshirë veprimtaritë sportive, kulturore dhe akademike, rrisin përvojën e të nxënësve tek studentët (pika 5.10)
- Zyra e Studentëve të Diplomuar dhe Karrierës ndjek ish-studentët që mund të mos kenë gjetur punësim dhe vazhdon t'i mbështesë ata me njoftime, këshilla dhe udhëzime për vende të lira pune (pika 5.11).

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë të dobësi në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk bëri asnjë rekomandim në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- Zhvillimi i sistemeve të reja në internet për menaxhimin e të dhënave dhe informacionit, me qëllim ofrimin e një qasje më të gjerë për stafin dhe studentët (pika 2.13).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo fushë vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin janë përmbushur plotësisht.
- 2 Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Gjykim i përmbledhur

Grupi i vlerësimit i rekomandon Këshillit të Akreditimit që IAL Universiteti Marin Barleti i përmbush plotësisht standardet shtetërore të cilësisë.

Raport i detajuar

Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe menaxhimi i tij

- 1.1 IAL-ja ka sisteme të përshtatshme dhe efikase për organizimin dhe menaxhimin e tij, të cilat sigurojnë përmbushjen e standardeve të cilësisë. Organet drejtuese të Universitetit Marin Barleti (UMB) janë Rektorati, Senati Akademik, Bordi dhe Këshilli i Etikës. **[1 Statuti, 3 Rregulloret akademike, 12 Mbledhjet e Bordit]** Rektori është autoriteti më i lartë drejtues, i ndihmuar nga një Zëvendës Rektor dhe një Drejtor Ekzekutiv, të cilët së bashku përbëjnë Rektoratin. **[1 Statuti, 3 Rregulloret akademike]** Rektori drejton Senatin Akademik që ka përgjegjësi për marrjen e vendimeve akademike. Detyrat dhe autoriteti i tij përcaktohen në Statut, përfshirë garantimin e vizionit të Institucionit. **[1 Statuti, 66 kalendari i Senatit]** Senati Akademik përbëhet nga këta anëtarë: Rektori, Drejtori Ekzekutiv, Zëvendës Rektori, dekanët e fakulteteve, drejtorët e instituteve kërkimore dhe Drejtori i Zyrës për Cilësinë dhe Standardet. Për të siguruar përfaqësim të duhur të gjithë institucionit, senati ka edhe anëtarë të zgjedhur, përfshirë dy anëtarë nga çdo fakultet si përfaqësues të personelit akademik, një anëtar përfaqësues nga personeli administrativ dhe dy përfaqësues nga Unioni Studentor. **[1 Statuti; 11 Lista e vendimeve të Senatit 2011-2016]** Senati akademik diskuton çështje dhe nisma të reja, si dhe rekomandon ndryshime në Statut sipas kërkesës. **[1 Statuti]** Këshilli i Etikës përbëhet nga shtatë anëtarë të zgjedhur si përfaqësues të stafit akademik dhe këshillojnë Rektoren për çështjet etike, sipas rastit. **[1 Statuti; Kapitulli III, Standardi I.1 dhe Standardi I.2]**
- 1.2 Bordi ka në përbërje të tij anëtarë përfaqësues të aksionarëve dhe përcakton politikat e përgjithshme të organizimit, administrimit, zhvillimit dhe planifikimit strategjik. Anëtarët e Bordit janë figura publike që sjellin në Universitet përvojën e tyre në role administrative, ekonomike ose social-kulturore. **[1 Statuti, 67 Kalendari i Bordit]** Studentët përfaqësohen në Senat përmes zgjedhjes së dy përfaqësuesve nga radhët e studentëve. **[1 Statuti i UMB-së neni 35; Kapitulli III, Standardi I.2]** Rektorati përgatit projektbuxhetin në përputhje me çështjet me përparësi organizative, të cilat diskutohen dhe miratohen nga Bordi. **[1 Statuti; 13 Lista e vendimeve të Rektoratit; M2 Rektori; M3 Stafi drejtues; Kapitulli III, Standardi I.2]** Vendimet shpallen në intranet, dhe janë në dispozicion të stafit dhe studentëve. **[M6a Demonstrim TI; M4 Studentët; M5 Stafi akademik]**
- 1.3 Institucioni ka dy fakultete: Fakultetin Juridik, të Shkencave Sociale dhe Politike, me tre departamente dhe dy institute kërkimore; dhe Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë me tre departamente dhe një institut kërkimor. Struktura dhe personeli i fakultetit janë në përputhje me dispozitat ligjore për arsimin e lartë dhe janë miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit; menaxhimi i tyre kryhet sipas rregulloreve përkatëse. **[1 Statuti; 3 Rregulloret akademike; 44 Manuali i stafit]** Çdo fakultet ka një Këshill Fakulteti, i cili vepron si një organ kolegjal vendimmarrës i fakultetit dhe vendos për çështjet më të rëndësishme të mësimdhënies, kërkimit dhe kualifikimit. **[1 Statuti; 6 Rregullore e Departamentit të Drejtësisë; Kapitulli III Standardi II.1]** Çdo Këshill Fakulteti përbëhet nga Përgjegjësit e Departamenteve dhe pesë deri në shtatë anëtarë të zgjedhur nga stafi akademik i fakultetit. **[3 Rregullorja akademike; 4 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë]** Çdo fakultet ka nga një dekanat, i cili përbëhet nga Dekani, Zëvendës Dekani dhe përgjegjësit e departamenteve. Ky organ ka për detyrë të sigurojë mbikëqyrje strategjike të veprimtarisë akademike dhe kërkimore të fakultetit. **[1 Statuti; 3 Rregullorja akademike; 4 Rregullore e Shkencave të Aplikuara; Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.4 Strukturat e Institucionit ofrojnë një sërë mundësish për debat konstruktiv duke përfshirë drejtues të nivelit të lartë, staf akademik e administrativ, dhe përfaqësues të studentëve. Debatet zhvillohen në nivel programesh, departamenti, fakulteti dhe institucioni, dhe autoriteti përfundimtar vendimmarrës është Senati Akademik dhe Rektori. **[1 Statuti; 11 Lista e vendimeve të Senatit 2011-16]** Stafi inkurajohet të kontribuojë në zhvillime dhe diskutime. Përfaqësues të studentëve inkurajohen të ndjekin mbledhjet e fakulteteve. **[5 Rregullorja e brendshme e Departamentit të Drejtësisë; 4 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë]** Mendimet e studentëve përfshihen në procesin vendimmarrës përmes vlerësimit të programit, mendimeve mbi mësimdhënien dhe kryerja e anketimeve në

mbarë institucionin. **[02 Pyetësorët e studentëve; M4 Studentët; M7 Stafi mbështetës]** Përfshirja e stafit dhe studentëve u konfirmua nga drejtuesit e lartë, mësimdhënësit dhe Stafi mbështetës si dhe studentët e takuar nga grupi i vlerësimit. **[M2 Rektori, M5 Stafi mësimdhënës, M4 Studentët, M7 Stafi mbështetës, 1 Statuti; Kapitulli III, Standardi I.2 dhe Standardi I.3]**

- 1.5 UMB-ja ka hartuar një plan zhvillimi strategjik, i cili përcakton synimet dhe objektivat e tij deri në vitin 2020. **[2 Platforma e zhvillimit strategjik]** Zhvillimi i strategjisë dhe rishikimi i saj në vazhdimësi bëhet mbi bazën e përparësive rajonale dhe kombëtare të zhvillimit dhe të rrjetit të gjerë të lidhjeve me jashtë, duke përfshirë një numër institucionesh ndërkombëtare me të cilat UMB-ja ka marrëveshje. Rektori dhe Senati Akademik rishikojnë zhvillimet në mënyrë të vazhdueshme. **[M2 Rektori, 15 Lista e Marrëveshjeve dhe Memorandumeve, 1 Statuti; Kapitulli III, Standardi I.5]** UMB-ja gjithashtu merr pjesë në një numër veprimtarish ndërkombëtare **[19 Lista e aktiviteteve 2011-16]** të cilat përbëjnë bazën për angazhimet e tij në kërkime dhe zhvillime të reja në nivel evropian dhe botëror, përfshirë këtu edhe projektin Erasmus. **[20 lista e konferencave; Kapitulli III, Standardi I.4]**
- 1.6 UMB-ja ka hartuar strategjinë e saj 2010-20 në përputhje me planin kombëtar të Qeverisë Shqiptare për shtrirjen e demokratizimit, përmes zbatimit të reformave institucionale që synojnë modernizimin dhe anëtarësimin e plotë në Evropë. **[2 Platforma e zhvillimit strategjik; M2 Rektori]** Vizioni i UMB-së është të jetë një universitet i klasit botëror që synon të mendojë nga pikëpamja botërore ndërsa mbetet i përkushtuar ndaj përparësive vendore e rajonale dhe parimeve të të nxëniet gjatë gjithë jetës, **[2 Platforma e zhvillimit strategjik; M2 Rektori; M3 Stafi drejtues]** duke përfshirë angazhimin me punëdhënësit dhe organe profesionale, në drejtim të të cilave deri më sot është bërë progres. **[10 Lista e aktiviteteve; 41 Projekte]** Strategjia 10-vjeçare mbështetet në një plan zhvillimor pesëvjeçar dhe një plan trevjeçar që paraqesin detaje dhe identifikojnë objektivat afatshkurtra në rrugën drejt realizimit të strategjisë. **[2 Platforma e zhvillimit strategjik; Kapitulli III, Standardi I.5]**
- 1.7 Rektori është përgjegjës për garantimin e arritjes së objektivave strategjike të Bordit. Rektori ndihmohet në këtë rol nga Zëvendës Rektori, i cili punon ngushtë me dekanët e fakulteteve dhe drejtorët e instituteve kërkimore për të siguruar që qëllimet strategjike të institucionit të realizohen në veprimtaritë e tij të përditshme. **[M2 Rektori; M3 Stafi drejtues, 1 Statuti, 3 rregullore]** Institucioni synon të ketë qëllime të matshme dhe të lidhura me objektivat, të cilat shqyrtohen nga Rektorati dhe Senati. **[M3 Stafi i lartë drejtues, 76 Planet e Veprimit, 2 Strategjia; Kapitulli III, Standardi I.5]**
- 1.8 Komisioni i Sigurimit të Cilësisë është përgjegjës për sigurimin e përputhshmërisë me standardet e cilësisë. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga dy zyra: Zyra e Studimeve Bachelor dhe Zyra e Studimeve Master, që janë përgjegjëse për zhvillimin dhe shpalljen e veprimtarive të vlerësimit në Universitet. **[1 Statuti; 3 Rregulloret akademike; M3 Stafi drejtues; M7 Stafi mbështetës; Kapitulli III, Standardi I.4]** Raportet Vjetore të veprimtarisë akademike dhe kërkimore përgatiten nga Rektorati dhe dorëzohen në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. **[8 dhe 9 Raporte vjetore]** Raportet hartohen mbi bazën e të dhënave të performancës së studentëve, pranimin dhe pajtueshmërinë me rregulloret. **[M Studentët M4, M7 Stafi mbështetës, 57 - 59 Vendimet e Senatit]** Raportet e programeve dhe departamenteve diskutohen në nivel departamenti dhe institucioni, dhe vlerësohen nga komisione të posaçme të përbërë nga staf akademik dhe personel i cilësisë, ekspertë të jashtëm dhe studentë. **[13B 3, 7, 18, 31, 32, 43, 51-54, 57]** Raportet përbëjnë bazën për vlerësimin dhe rishikimin institucional dhe përfshijnë rekomandime për përmirësime. **[62 Analiza e punës e Fakultetit Juridik, Shkencave Sociale dhe Politike; 76 Plani i veprimit në lidhje me monitorimin vjetor; Kapitulli III, Standardi I.6]** Raportet përmbajnë informacion mbi analizën e përputhshmërisë me standardet e cilësisë, kërkesat e projektit dhe bashkëpunime, dhe përmes intranetit të institucionit, ato iu vihen në dispozicion stafit dhe studentëve. **[M2 Rektori, M4 Takim me studentët; M5 Stafi akademik] M6a Demonstrim TI]** Progresi i strategjisë institucionale dhe raportet vjetore monitorohen përmes hartimit të planeve të veprimit, të cilat diskutohen në nivel të lartë drejtimi dhe departamenti. **[M2 Rektori, M3 Stafi i lartë drejtues, 76 Planet e Veprimit]** Grupi i vlerësimit identifikoi si **praktikë të mirë** qasjen sistematike të Institucionit për t'iu përgjigjur çështjeve të ngritura nga proceset e cilësisë,

përmes hartimit dhe zbatimit të planeve të veprimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të ecurisë. **[Kapitulli III, Standardi I.4; Standardi ESG I.1]**

- 1.9 Studimi i tregut kryhet për të mbledhur informacion për hartimin e programeve të reja, si dhe për të monitoruar kërkesën për programe. Për shembull, për hartimin e programit Bachelor në sektorin e bankës u mbledh informacion bazë të nxjerrë nga ekspertët e sektorit. **[13 Vendimet e Rektorëve, pjesa B-3, 18; M6 Partnerët e jashtëm dhe punëdhënësit]** UMB këshillohet gjithashtu me shkollat e mesme vendase për të mbledhur informacion në lidhje me kërkesat e studentëve dhe aspiratat e mundshme për zhvillim, si dhe monitoron aplikimet për ofrimin e lëndëve. **[M6 Partnerët e jashtëm dhe të diplomuarit, M2 Rektori, M5 Mësimdhënia, M3 Stafi i lartë drejtues, 36 Regjistrimet e studentëve; 39 Provimet, kursi, dëshmia e notave, 41.2 Projekti dhe Aktivitetet e IEB-së; Kapitulli III, Standardi I.4]** Studentët kanë mundësi të marrin këshilla për sigurimin e punësimit pas diplomimit përmes Zyrës së Studentëve të Diplomuar dhe Karrierës. **[31 Plani Strategjik i Zyrës së Alumnit dhe Karrierës]**
- 1.10 UMB është duke punuar për të zhvilluar një rrjet bashkëpunimi në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, si pjesë përbërëse të strategjisë institucionale. **[2 Platforma e zhvillimit strategjik]** Studentët kanë përfitur nga bashkëpunimi me institucionet vendore përmes leksioneve të shpeshta nga të ftuar, praktikave dhe mundësive të caktimit në praktika, si dhe përmes pjesëmarrjes në projekte me jashtë. **[M3 Stafi i lartë drejtues, 19 Aktivitete, 20 Leksione, konferenca dhe seminare; Projekti i IEB dhe aktivitetet]** UMB-ja ka lidhur një gamë të gjerë marrëveshjesh, veçanërisht kur studentët dërgohen për sistemim në praktika. **[M3 Stafi i lartë drejtues, 15 Lista e marrëveshjeve, 17 Lista e Lëvizshmërisë]** UMB ka krijuar lidhje me organizata dhe universitete rajonale dhe ndërkombëtare, përfshirë Universitetin Klemson dhe Shkollën Klinton në Universitetin e Arkansas, si dhe me universitete italiane. **[15 lista e marrëveshjeve institucionale, 16 Lista e aktiviteve ndërkombëtare; Kapitulli III, Standardi II.1]** Institucioni gjithashtu ofron një program doktorature për Studime ndërkombëtare për familjen dhe komunitetin, ofruar nga Universiteti Klemson, në gjuhën angleze. **[8 Raport vjetor, 2 Strategji, 15 Marrëveshje; Kapitulli III, Standardi II.1]** UMB ka lidhur gjithashtu marrëveshje pune me universitete evropiane, gjë që lehtëson vizitat dhe shkëmbimet, si dhe marrëveshje për të punuar në projekte të përbashkëta dhe diploma të përbashkëta, në veçanti me Universitetin e Barit dhe Universitetin e Napolit për ofrimin e programeve në bashkëpunim. **[15 Lista e Marrëveshjeve dhe Memorandumeve; M3 Stafi i lartë drejtues; M5 Stafi akademik; Kapitulli III, Standardi III.2]**
- 1.11 Kjo IAL përdor partneritetet e saj me jashtë si bazë informimi për zhvillimin e kurrikulave, për të mbledhur informacion mbi tregun dhe për të ofruar mundësi punësimi. Anëtarët e jashtëm të Bordit diskutojnë dhe informojnë zhvillimin e partneriteteve që mund t'u shtojnë vlerën mundësive që kanë studentët për të studiuar dhe për t'u punësuar. **[19 Lista e veprimtarive; 15 Lista e marrëveshjeve; M6 Partnerët e jashtëm dhe punëdhënësit]** Aty ku është e mundur, fokusi është tek përfitimi reciprok. Institucioni ofron përdorimin e ambienteve të tij për trajnimin e punëdhënësve, si dhe ofron mundësi që punëdhënësit dhe profesionistët të jenë lektorë me kohë të pjesshme. **[M3 Stafi i lartë drejtues, M6 punëdhënësit dhe të diplomuarit, 15 listat e marrëveshjeve, 41 Aktivitetet e IEB]** Zyra e Studentëve të Diplomuar dhe Karrierës harton dhe përditëson kontaktet e punëdhënësve dhe të diplomuarve që përbëjnë bazën e një rrjeti të larmishëm të kontakteve në tregun e punës. Informacioni i mbledhur dhe të dhënat e kontaktit ndihmojnë për t'u ofruar studentëve mundësi praktike profesionale dhe punësimi. Për më tepër, përmes kontakteve të rregullta me të diplomuarit, Zyra e Studentëve të Diplomuar dhe Karrierës është e aftë të ofrojë informacion të vazhdueshëm mbi nevojat e tregut, mundësitë e punësimit dhe zhvillimin e kurseve. Studentët raportojnë se ndihmesa e ofruar për gjetjen e praktikave dhe punësimit është e vazhdueshme dhe e dobishme. **[31 Plani Strategjik i Zyrës së Alumnit dhe të Karrierës; 28 Të dhëna për ish të diplomuarit; M7 Stafi mbështetës; M6 Partnerët e jashtëm dhe Punëdhënësit]** Grupi i vlerësimit çmoi si praktikë të mirë përdorimin e bashkëpunimeve dhe studimin e tregut për të mbledhur informacion që ndihmon Institucionin në formimin e të diplomuarve me aftësi, njohuri dhe botëkuptim të përshtatshëm. **[Kapitulli III, Standardi III.1 dhe Standardi III.3]**
- 1.12 Stafi inkurajohet të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe në programet e shkëmbimit të lektorëve. Institucioni merr pjesë në projektin ndërkombëtar Tempus, ndër iniciativa të tjera. **[M3 Stafi drejtues, 15 lista e marrëveshjeve institucionale; 16 Lista e aktiviteve**

ndërkombëtare; 17 Lista e lëvizshmërisë] Personeli mbështetet të marrë pjesë në shkëmbimin e lektorëve vizitues, përfshirë këtu edhe programin Fulbright me universitetet amerikane. **[17 Lista e marrëveshjeve dhe të dhënave të Lëvizshmërisë; 16 Lista e pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare; 10 Lista e stafit të UMB-së në programit "Braingain Fulbright"; M5 Stafi akademik]** Kjo punë mbështet zhvillimin e gjerë të UMB-së dhe stafit të tij, dhe ofron mundësi për të krijuar lidhje institucionale. **[Kapitulli III, Standardi III.3]**

- 1.13 UMB synon të jetë në përputhje me Procesin e Bolonjës dhe të ofrojë kurrikula të orientuara ndërkombëtarisht. **[2 Strategjia, SER fq.9]** Kjo IAL deklaron se është e hapur për pranimin e studentëve nga vende të tjera, dhe ka pritur disa studentë amerikanë për vizitat dhe veprimtari verore. **[15 lista e marrëveshjeve institucionale; 16 Lista e veprimtarive ndërkombëtare]** Të dhënat institucionale tregojnë se numri i bursave të studentëve po rritet nga viti në vit. **[Të dhënat institucionale]** Një numër leksionesh janë mbajtur nga pedagogë të huaj dhe staf akademik i ftuar. **[15 lista e marrëveshjeve institucionale; 16 Lista e veprimtarive ndërkombëtare; Kapitulli III, Standardi III.4]**
- 1.14 UMB përmbush standardet e cilësisë për menaxhimin dhe organizimin e tij, siç dëshmohet nga struktura e mbledhjeve vendimmarrëse dhe monitorimi e vlerësimi i performancës në nivel fakulteti dhe organizimi. Senati dhe Rektorati punojnë për të garantuar që zhvillimi institucional të planifikohet dhe zbatohet me kujdes, dhe që bashkëpunimet dhe studimit i tregut të përdoren si bazë për hartimin e ofertës së programit. Shqyrtimi sistematik i çështjeve dhe planeve të veprimit dhe puna me partnerë për të mbështetur studimin bazuar në praktikë, janë praktika të mira.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi praktikat e mira me karakteristikat e mëposhtme:

- Qasja sistematike e Institucionit si reagim për zgjidhjen e problemeve të ngritura nga proceset e cilësisë përmes hartimit dhe zbatimit të planeve të veprimit (pika 1.8)
- Përdorimi i bashkëpunimeve dhe kërkimi i tregut, si bazë për mbledhjen e informacionit, është një praktikë që ndihmon Institucionin të nxjerrë të diplomuar me aftësi, njohuri dhe botëkuptim të përshtatshëm (pika 1.11).

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë të dobësi në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk bëri asnjë rekomandim në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim në proces në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Vlerësimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 UMB ka një strukturë të qartë organizative e cila përcakton përgjegjësitë për menaxhimin e burimeve. Vendet e lira të punës shpallen në faqen e internetit të Institucionit, rrjetet sociale dhe gazeta. **[18 shpallje për të lira pune; 74 evidenca; 1 Statuti]** Përgjegjësia e përgjithshme për menaxhimin dhe rekrutimin bie mbi Rektorin, dhe vendimet diskutohen dhe miratohen nga Bordi dhe Senati. **[1 Statuti; 11 lista e mbledhjeve të Senatit; 12 Bordi]** Politikat dhe kriteret e rekrutimit menaxhohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore. **[1 Statuti; 3 rregulloret akademike; Ligji Nr. 9741 2007; 13 lista e vendimeve, urdhrave dhe udhëzimeve të Rektorit]** Institucioni kërkon, sipas rastit, të rekrutojë ish-studentë dhe punëdhënës me kohë të pjesshme. **[10 Lista e stafit; M3 Stafi i lartë drejtues; M5 Stafi akademik; M6 Partnerët e jashtëm; M7 Stafi mbështetës]** Për të siguruar më tej cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit, rekrutohet personel me kualifikim dhe përvojë mësimore të fituar jashtë vendit. Përvoja në mësimdhënie në një universitet përëndimor është kriter për profesorët. **[10 Lista e stafit; Statuti I; 3 Rregulloret akademike]** Organigrama është e shpallur në internet në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara. **[77 Lidhjet e internetit - organigrama dhe diagrama e vendimmarrjes; Kapitulli III, Standardi IV.1; ESG 1.5 Stafi i mësimdhënës]**
- 2.2 Integrimi i stafit të ri mbështetet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, siç përcaktohet në Statutin e IAL-së, duke përfshirë njohjen me funksionet dhe objektet e organizatës. **[1 Statuti; Pyetësori i stafit; SED fq.19]** Personeli i ri akademik mbështetet nga një koleg më me përvojë, i cili vepron si mentor dhe e nxit të përfshihet në një sërë veprimtarish, përfshirë trajnime, seminare dhe aktivitete shoqërore. **[19 Lista e Aktiviteteve; 20 Lista e konferencave, seminareve dhe aktiviteteve trajnuese; Stafi akademik M5; M7 Stafi mbështetës]** Si pjesë e procedurave të integritit të Institucionit, personeli akademik dhe mbështetës angazhohen në hartimin e materialeve të kursit dhe broshurave për studentët e ardhshëm, si dhe japin kontribut gjatë Ditëve të Hapura dhe aktiviteteve të tjera. **[45 dhe 46 Broshura; 47 Bachelor për Psikologji; 48 Bachelor për Sociologji; 74 Evidenca shtesë; M7 Stafi mbështetës; Kapitulli III Standardi IV.2]**
- 2.3 UMB zbaton një politikë të vlerësimit periodik të aftësive të stafit, gjë që merret në konsideratë kur ka aplikime për ngritje në detyrë. **[40 format formular vlerësimi; 8 dhe 9 Raporte vjetore]** Procesi ndërmerret nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe rezultatet përfshihen në raportet vjetore, duke i kushtuar rëndësi të veçantë çështjeve që kanë të bëjnë me kërkimin dhe veprimtarinë në kuadrin e projekteve me jashtë. **[8 Raport vjetor 2014-15; 9 Raporti mbi kërkimet shkencore dhe projektet 2015]** Për shembull, Plani i Veprimit për vitin 2013-14, i hartuar nga Rektori, përcakton kërkesat për departamentet lidhur me monitorimin e performancës së të gjithë stafit. **[75 Plani i veprimit për monitorimin vjetor; M2 Rektori]** Plani përfundimtar i trajnimit pasqyron nevojat e identifikuar të zhvillimit të stafit dhe zhvillimet e planifikuara të institucioneve. **[20 Lista e konferencave, seminareve dhe trajnimeve / B, C; 2 Platforma e zhvillimit strategjik; Kapitulli III Standardi IV.3]**
- 2.4 UMB nxit stafin akademik të angazhohet në programe dhe projekte me universitete në Evropë dhe në SHBA përmes një sërë memorandumesh bashkëpunimi. **[16 Lista e veprimtarive ndërkombëtare; 17 Lista e marrëveshjeve për lëvizshmërinë; Stafi akademik M5; M3 Stafi i lartë drejtues]** Leksionet e hapura që mbahen nga stafi me përvojë i UMB-së dhe lektorë të ftuar nga institucione të tjera janë të hapura për të gjithë personelin. **[20 Lista e konferencave, seminareve dhe trajnimeve; Stafi i lartë drejtues M3; M5 Stafi akademik]** Lektorët kanë gjithashtu mundësi të studiojnë për qëllime kualifikimi (deri në një vit) në universitete të huaja. **[17 / Lista B e marrëveshjeve të lëvizshmërisë; Mbledhje stafi M3; M5 Stafi akademik]** Në nivel vendi, UMB organizon një sërë aktiviteteve për të nxitur dialogun social dhe bashkëpunimin me institucione të ndryshme. **[1 Statuti, Studentët M4; Stafi akademik M5; 19 Lista e aktiviteteve; Kapitulli III Standardi IV.3]** Personeli ka dijeni për përgjegjësitë e tij dhe orientohet në përputhje me rregulloret e përcaktuara në Manualin e Stafit, të cilat përfshijnë ngarkesën mësimore, rregulloret e programit dhe udhëzimet e institucionit. **[1 Statuti; 3 Rregulloret akademike; 13 Lista e vendimeve, urdhrave dhe udhëzimeve të Rektorit; 70 Orët e mësimdhënies dhe ngarkesa e punës; Stafi i lartë drejtues M3; M7 Stafi mbështetës; Kapitulli III Standardi II.2]**

- 2.5 Përmes Statutit, rregulloreve dhe manualeve të tij, Institucioni dëshmon një politikë të qartë të zhvillimit shoqëror. **[1 Statuti; M3 Stafi i lartë drejtues]** Stafi dhe studentët nxiten të angazhohen në projekte shoqërore, tryeza të rrumbullakëta dhe seminare. Ngjarjet e organizuara nxisin angazhimin institucional në drejtim të zhvillimit shoqëror dhe komunitetit, përfshirë aktivitetet sportive. **[41 Projekte; 42 aktivitete të BIRD; Studentët M4; 1 Statuti; Stafi akademik M5; M7 Partnerët e jashtëm]** Për të mbështetur mirëqenien e stafit, UMB-ja ka policë të sigurimit të jetës dhe shëndetit, ku përfshihen marrëveshje me shoqëri private për të ofruar akses në shërbime mjekësore për stafin e tij. **[15 / A listë e marrëveshjeve; Stafi i lartë drejtues M3; Kapitulli III Standardi IV.4]**
- 2.6 Mbikëqyrja financiare dhe planifikimi i buxhetit menaxhohen në përputhje me rregulloret ligjore. Rektorati është përgjegjës për hartimin e buxhetit sipas rregullave dhe standardeve për administrimin e financave publike. **[51 Pasqyra buxhetore/financiare; M7 Stafi mbështetës]** Projekt buxheti i dorëzohet Senatit për diskutim dhe miratim, dhe më pas Bordit për ratifikimin përfundimtar. **[1 Statuti; 51 Pasqyra Buxhetore / Financiare; Lista e diskutimeve në Senat; 13 mbledhjet e Bordit]** Pas miratimit, shpërndarjet buxhetore i kalojnë fakulteteve dhe departamenteve. **[M2, Rektori; Stafi i lartë drejtues M3; M5 Stafi akademik]** Zyra e Financës është përgjegjëse për zbatimin e politikave financiare. Ajo vepron në përputhje me kërkesat ligjore dhe harton pasqyra financiare transparente ndaj palëve të jashtme të interesit. **[51 Pasqyrat e buxhetit dhe e pasqyrat financiare; Stafi i lartë drejtues M3; Kapitulli III Standardi VI.2]** Kontrolli financiar dhe buxhetor kryhet nga auditi i brendshëm dhe i jashtëm. Çdo vit financiar, bilancet dhe pasqyrat financiare auditohen nga ekspertë kontabël dhe rishikohen nga ekspertë të Zyrës së Tatimeve, përpara auditimit të jashtëm. **[1 Statuti; 51 Pasqyra buxhetore/financiare; Kapitulli III Standardi IV.1 dhe Standardi IV.3]**
- 2.7 UMB-ja ka një sistem intraneti dhe të menaxhimit të informacionit që siguron akses në informacionin e kursit dhe një bazë të dhënash për regjistrimet dhe rezultatet e studentëve. **[49 Intraneti; M6a Demonstrim TI]** Sistemi menaxhohet nga Zyra e TI-së me të dhëna nga pranimet dhe stafi i fakultetit. **[M6a Demonstrim TI; 29 Rregullore e brendshme e regjistrimit të të dhënave të studentëve]** Intraneti është vendgrumbullimi kryesor i të dhënave të studentëve dhe stafit, informacionit mbi programet e studimit, ofertat akademike, dokumentacionit përkatës ligjor, si dhe raportet e lidhura me to. **[49 Intraneti; M6a Demonstrim TI]** Në sistem regjistrohet edhe informacion në lidhje me të diplomuarit, si komunikimi i vazhdueshëm me të diplomuarit. **[28 Të dhëna për ish të diplomuarit; Kapitulli III Standardi VII.1]**
- 2.8 Stafi dhe studentët kanë qasje në burimet në internet përmes intranetit, duke përfshirë informacionin dhe materialet e kursit. **[75 Informacion mbi burimet e kampusit 1; 44 Manuali i stafit]** Sistemet kompjuterike janë ngritur në bashkëpunim me një shoqëri të jashtme, e cila ka ndihmuar UMB-në me instalimin e të dy programeve të nevojshme dhe për të pajisur të dy kampuset me kompjuterë. **[15A Lista e Marrëveshjeve; 4.2 Projekte dhe aktivitetet IEG]** Studentët kanë akses në kompjuterë në laboratorë, dhomat e shkencave kompjuterike dhe bibliotekë, si dhe përmes laptopëve të vënë në dispozicion për t'u përdorur prej tyre. Planet mësimore dhe materialet mbështetëse të mësimdhënies janë gjithashtu të disponueshme në internet. **[75 Informacione mbi Kampusin 1; M7 Stafi mbështetës; Studentët M4; Kapitulli III Standardi VII.2; ESG 1.6 Burimet e të mësuarit dhe mbështetja e studentëve]**
- 2.9 UMB-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe përditësimin e inventarit të gjitha objekteve, i cili mbahet me një standard të lartë. UMB-ja mban inventarin e të gjitha objekteve në të dy kampuset e tij, dhe ka plane për zgjerimin e ambienteve të tij. **[2 Platforma e zhvillimit strategjik; Kapitulli III Standardi VII.3; 15 / A, Lista e Marrëveshjeve; 79 Informacion mbi Kampusin 1; M2 Rektori; vizitat në terren]** Standardi i lartë i pajisjeve në fushën e mësimdhënies dhe të nxënit përfshin orëditë moderne, kompjuterët dhe projektorët. Për të marrë informacion mbi cilësinë e logjistikës dhe ambienteve, kryhen disa anketime të studentëve dhe rezultatet e tyre përbëjnë informacionin bazë për zhvillimin e vazhdueshëm të shërbimit dhe ambienteve. **[40 Format pyetësorësh, M3 Mbledhja e stafit drejtues; Stafi akademik M5; M7 Stafi mbështetës]** Përdorimi i pajisjeve, në të gjitha fushat e mësimdhënies, që iu ofrojnë studentëve një ambient të nxënimit me cilësi të lartë është **praktikë e mirë**. Bibliotekat dhe sallat e konferencave mbështesin aktivitetet e mësimore, si dhe konferencat, seminarat dhe organizime të tjera. **[vizita në terren; 20 lista e konferencave; M7 Stafi**

mbështetës] Zhvillimet më të fundit janë ndërtimi i një salle sportive për edukimin fizik dhe sportet, dhe marrja me qira e ambienteve shtesë për të mbështetur gamën e plotë të studimeve sportive. **[01 SED fq. 22; vizita në terren, 2 Platforma e zhvillimit strategjik; M2 Rektori; M7 Stafi mbështetës]** Salla e re sportive është në dispozicion edhe të komunitetit vendas në mbrëmje. **[M6 Partnerët e jashtëm]** Përdorimi i ambienteve sportive për të mbështetur praktikimin e sportit, aktivitetet jashtëshkollore dhe ofrimin e ambientit për komunitetin vendas është **praktikë e mirë**. UMB-ja ndjek një politikë të ruajtjes së trashëgimisë akademike, kulturore dhe shkencore, si pjesë e përgjegjësisë të saj të vazhdueshme për menaxhimin efikas të burimeve. **[38 Politika e ruajtjes së trashëgimisë institucionale; Kapitulli III Standardi VII.4]**

- 2.10 Megjithëse Institucioni ka biblioteka në të dy kampuset e tij, vihen në dispozicion një numër relativisht i vogël librash, por një numër më i madh tekstesh janë në dispozicion në mënyrë elektronike për të mbështetur studentët në të gjitha programet. Megjithatë, tekstet elektronike mund të lexohen vetëm në kampus, pavarësisht se Institucioni po punon për ta bërë bibliotekën më të arritshme, specifike sipas kurseve, dhe efikase. **[vizita në terren; Studentët M4; 02 Anketimi i studentëve]** Stafi dhe studentët gjithashtu kanë akses në libra në internet përmes marrëveshjeve me Universitetin Klemson, Bibliotekën Otenheimer të Universitetin e Arkansas dhe Bibliotekën Elektronike të Oregonit. **[vizita në terren; M7 Stafi mbështetës; 01 SED fq.33; 15 Lista e marrëveshjeve; 16 Lista e veprimtarive ndërkombëtare]** Fakti që studentët nuk kanë qasje në burimet e bibliotekës, përveçse përmes mjeteve TI në kampus, u identifikua si një fushë që ka nevojë për zhvillim për të arritur akses më të gjerë. Grupi i vlerësimit sugjeron që një larmi më e madhe dhe numër më i madh titujsh dhe tekstesh të vihen në dispozicion përmes bibliotekave të kampusit për të mbështetur studentët universitarë. **[Kapitulli III Standardi VII.5]**
- 2.11 UMB-ja dëshmon **praktikë të mirë** në mbështetjen e nxënësve të shkollave të mesme në vitin e tyre të fundit, për përgatitjen e provimeve të Maturës Shtetërore, gjë që mbështet progresin e tyre në arsimin e lartë, si në UMB ashtu edhe në universitete të tjera. **[Stafi i lartë drejtues M3; Stafi akademik M5; M7 Stafi mbështetës; 01 SER p 23]** Orët e hapura që i ofrohen nxënësve të shkollave të mesme përfshijnë teste në gjuhën angleze, përgatitjen dhe përdorimin e lëndëve, dhe qasje në ambientet e gjera të institucionit. Ky angazhim dëshmon zotimin e UMB-së për të mbështetur aksesin në arsimin e lartë dhe zotimin ndaj nevojave të komunitetit vendor. Gjithashtu mendimi i studentëve kërkohet për të ndihmuar në zhvillimin e mëtejshëm të shërbimit. **[M2 Rektori; 40 Modelet e pyetësorëve; M3 Stafi i lartë drejtues, 01 SER p 23; Stafi akademik M5; Kapitulli III Standardi VII.6]**
- 2.12 Të dy kampuset janë ndodhen brenda brezit të gjelbër të qytetit dhe objektet plotësojnë kërkesat ligjore. Ambientet janë të pajisura me ajër të kondicionuar / ngrohje dhe materialet e ndërtimit të mbrojnë nga lagështia dhe ndotja akustike. **[01 SER p24; 1 Statuti; vizita në terren; Informacion mbi Kampusin 1]** Mësimdhënia, mjediset teknike, bibliotekat, dhomat audiovizive dhe laboratorët ofrojnë ambient cilësor, me akustikë dhe pajisje të mira. Për Departamentin e TI-së dhe Arkitekturës, UMB ofron një infrastrukturë të përshtatshme teknike, përfshirë programet përkatëse kompjuterike. **[75 Informacion mbi Kampusin 1; vizita në terren; Studentët M4; M5 Stafi akademik]** Planet e kateve tregojnë se lartësia e dhomave të mësimin është mbi 3.0 m, dhe dritaret zënë një sipërfaqe që tejkalon 20 për qind të sipërfaqes së dyshemesë. **[42 Projektet dhe Aktivitetet e BIRD; 79 Plan i kateve dhe vizita në terren; SED fq.24]** Të gjitha godinat janë në përputhje me kërkesat për shkallët e daljes së urgjencës dhe mbrojtjen nga zjarri. Institucioni ka gjeneratorë dhe cisterna për magazinimin e ujit në të dy kampuset. **[42 Certifikata Teknike për Mbrojtjen nga Zjarri, Plani Mjedisor; vizita në terren; Stafi i lartë drejtues M3; Stafi akademik M5; M7 Stafi mbështetës; Kapitulli III Standardi V.1]** Stafi ka hapësirën e vet të zyrës, stafi drejtues ka zyra individuale, ndërsa stafi më i ri kanë zyra të përbashkëta. **[75 Informacioni i kampusit; vizita në terren]**
- 2.13 Zyra e Rektorit është përgjegjëse për ruajtjen e gjithë dokumentacionit përkatës në lidhje me menaxhimin e Institucionit. Dokumentet mbahen në kopje të printuara dhe përfshijnë regjistrin e vendimeve të Senatit dhe Bordit. **[M2 Rektori; M7 Stafi mbështetës; 8 Raporti Vjetor; 49 Intraneti; 74 evidenca shtesë]** Në nivel departamenti, përgjegjësi ruan kopje të programeve dhe kurrikulave për programet Bachelor dhe Master. **[Stafi i lartë drejtues M3; Stafi akademik M5; 24 Kurrikula; 27 Programe Master dhe Bachelor]** Baza e të dhënave elektronike

mbështet regjistrimin e aplikimeve të studentëve, regjistrimet, kualifikimet dhe notat paraprake, në përputhje me kërkesat ligjore. **[M6a Demonstrim TI; M7 Stafi mbështetës; 3 Rregulloret akademike]** Sekretariati i Institucionit mban një regjistër të përhershëm të studentëve (në letër dhe në format elektronik) duke përfshirë informacion të vlerësimeve/ notave të studentëve dhe çdo ndryshim që ka ndodhur gjatë programit. UMB-ja po ecën drejt ruajtjes elektronike, gjë që do të përmirësojë aksesin në informacion dhe do të mbështesë monitorimin, vlerësimin dhe sistemet e raportimit. **[29 Rregullorja e brendshme mbi të dhënat e studentëve; M7 Stafi mbështetës]** Stafi dhe studentët kanë akses në planet mësimore dhe kreditet e detyrueshme të kurseve për nivele të ndryshme. **[49 Intraneti; M6a Demonstrim IT; Stafi i lartë drejtues M3; Stafi akademik M5; M7 Stafi mbështetës]** Grupi vlerësues thekson gjithashtu se zhvillimi i sistemeve të reja në internet për menaxhimin e të dhënave dhe informacionit ofron një qasje më të gjerë për stafin dhe studentët. **[Menaxhimi i Informacionit i ESG 1.7 dhe Kapitulli I, Standardi V.2]**

2.14 Standardet e cilësisë për burimet janë përmbushur plotësisht. Institucioni ofron akomodim dhe ambiente sportive të pajisura mirë dhe të mirëmbajtura. Gjithashtu ka sisteme të reja në linjë që mundësojnë qasjen në informacion. Këto rrisin përvojën e të nxënësve dhe përbëjnë praktika të mira. Mbështetja e nxënësve të vitit të fundit të shkollave të mesme për përgatitjen për provimet përfundimtare është gjithashtu një praktikë e mirë. Ambientet e bibliotekës do të zhvilloheshin më tej nëse përfshihet përdorimi i tyre edhe jashtë kampusit. Sistemet e menaxhimit të të dhënave dhe informacionit vazhdojnë të zhvillohen për të ofruar akses më të madh.

Gjetjet

Provat dëshmojnë se Institucioni përmbush standardet.

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi praktikën e mira me karakteristikën e mëposhtme:

- Standardi i lartë i pajisjeve në të gjitha fushat e mësimdhënies u krijon studentëve një ambient të nxënësve me cilësi të lartë (pika 2.9)
- Ambientet sportive mbështesin në mënyrë efektive programet sportive, aktivitetet jashtëshkollore e ofrojnë edhe ambiente komunitare (pika 2.9)
- Dhënia e ndihmesës dhe mbështetja falas për nxënësit e vitit të fundit të shkollave të mesme për t'u përgatitur për provimet dhe përpunimin e tyre në arsimin e lartë (pika 2.11)

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë të dobësi në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk bëri asnjë rekomandim në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Pohime

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohon veprimet në proces si më poshtë:

- Zhvillimi i sistemeve të reja në internet për menaxhimin e të dhënave dhe informacionit do të nxisë një akses më të gjerë për stafin dhe studentët (pika 2.13).

--

Vlerësim

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Ka sisteme të qarta për të siguruar përmbushjen e standardeve të cilësisë që zbatohen për kurrikulën. Institucioni ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë, në pajtim me standardet e Bolonjës, e në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, legjisllacionin shqiptar dhe dispozitat e Statutit dhe Rregulloreve të veta Akademike. **[SER p27, 1 Statuti]** Që nga viti 2012, ai gjithashtu ofron një program doktorate në shkencat sociale përmes bashkëpunimit me Universitetin Klemson. **[M3 Takimi me Stafin e Lartë, RVV fq.28, 62 Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Shoqërore, 65, Raport vjetor, 15 Lista e marrëveshjeve, 52/A Akreditime]** Programet Bachelor janë të strukturuar në lëndë kryesore dhe dytësore, që sipas UMB-së e bëjnë shërbimin më tërheqës për studentët dhe punëdhënësit. Struktura i lejon studentët të përshtatin programet e tyre sipas kërkesave të karrierës që ata synojnë. **[RVV p27, 1 Statuti, 6 Rregullore për studentët e programeve Bachelor]** UMB ofron informacion të qartë në lidhje me shërbimet e tij. Ky informacion është në dispozicion përmes faqes së tij në internet dhe përmes ditëve të hapura e fletëpalosjeve të informacionit mbi programin. **[Studentët M4; faqja në internet - www.umb.edu.al ; 45 dhe 46 Broshura]** Vepohet me një sistem të qartë pranimesh, i cili i shqyrton aftësitë e studentëve, siç dëshmohet nga arrijtet paraprake akademike dhe kategorizohen nga stafi i UMB-së për pranimet dhe stafi akademik. **[36 Politikat dhe kriteret e pranimi; 6 Rregullore e Programit Master; M7 Stafi mbështetës; Kapitulli I, Standardi I.1; ESG 1.8 Informacion Publik]**
- 3.2 Numri i studentëve është rritur me shpejtësi gjatë viteve të fundit (544 në 2013/14 në 1,026 në 2015/16) dhe stafi i lartë drejtues tregon se tani i mëshohet më shumë rëndësi cilësisë dhe jo sasisë. **[M3 Takimi me stafin me përvojë, të dhënat institucionale]** Pavarësisht rritjes së numrit të studentëve, kohët e fundit, UMB-ja vazhdon të operojë brenda kapacitetit, dhe raporti staf-student është i përshtatshëm dhe në përputhje me kërkesat ligjore. **[M3 Takim me stafin e lartë drejtues, të dhëna institucionale]** Statuti lejon që institucioni të angazhohet në procesin e të nxënimit gjatë gjithë jetës, duke ofruar programe studimore afatshkurtra, në mënyrë të pavarur, ose në bashkëpunim me organe publike ose private. **[1 Statuti, 15 Lista e marrëveshjeve dhe memorandumeve]** Departamenti i Shkencave të Aplikuara ofron një gamë të gjerë kurseesh të shkurtra për Biznes dhe Menaxhim, Informatikë (kryesisht kurse për paketat e zakonshme të programeve, si Microsoft Office), Gjuhë Angleze dhe Certifikatë në Studime ndërkombëtare për familjen dhe komunitetin (me Universitetin Klemson, SHBA). **[Evidenca 2, Plani strategjik, 52 Akreditime; Kapitulli I, Standardi I.2]**
- 3.3 Institutet kërkimore kanë një numër projektesh që përfshijnë arsimin e vazhdueshëm që janë pjesë e strategjisë së zhvillimit të UMB-së. **[2 Platforma e zhvillimit strategjik ; M3 Stafi i lartë drejtues]** Instituti Shqiptar për Çështjet Publike punon ngushtë me shkollat për të ofruar trajnime dhe kurse të vazhdueshme të zhvillimit profesional. **[41.1 Raporti vjetor i AIPA; M6 Takim me Punëdhënësit]** Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti" ofron projekte të tilla si Projekti Tirana Innovation Hub. Këto projekte synojnë të promovojnë dhe përkrahin përfshirjen shoqërore dhe programet e punësimit të qëndrueshëm për të rinjtë, përmes ngritjes së kapaciteteve dhe zhvillimit të bashkëpunimeve. **[41, raporti vjetor i BIRD; M6 Takimi me Punëdhënësit; Takim me studentët]** Instituti i Edukimit Barleti ka një numër të madh modulesh trajnimi në arsimin parauniversitar për mësuesit dhe drejtuesit e arsimit. **[41.2 Raporti vjetor i IEB-së]** UMB punon gjithashtu me institucione të arsimit parauniversitar, në veprimtari dhe projekte të përbashkëta që promovojnë Institucionin dhe ndihmojnë në përgatitjen e nxënësve të shkollave të mesme për pranimin në universitet. **[Evidenca 41; Evidenca 41.1; Evidenca 41.2; Evidenca 20; Kapitulli I, Standardi I.3 dhe Standardi I.4]**
- 3.4 Modulet e akademike dytësore që janë ofruar si kurse të shkurtra për palë jashtë institucionit, tashmë ofrohen edhe si studime përgatitore afatshkurtra dhe lëndë me zgjedhje për studentët, në fusha të tilla si Administrata Publike, Psikologji, Financë, Ekonomi, Sociologji dhe Arsimit. Pas përfundimit të këtyre kurseve përgatitore, pjesëmarrësit marrin një certifikatë. **[M2 Ekipi i Vetëvlerësimit, M3 Stafi i lartë drejtues, 3 rregullore, 52 akreditime]** Grupi vlerësues e çmon qasjen e UMB-së ndaj të nxënimit gjatë gjithë jetës si praktikë të mirë, e cila promovohet përmes përdorimit të elementeve të programeve të diplomimit duke përfshirë modulet dytësore, për të siguruar zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe qasje në arsimin e lartë, si dhe mbështetjen e njohurive dhe botëkuptimit që lehtësojnë punësimin. **[Kapitulli I, Standardi I.4]**

- 3.5 Miratimi i programit dhe proceset e rishikimit sigurojnë që programet e studimit të ofrohen në përputhje me prirjet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ato përfshijnë shqyrtimin e kërkesave vendore dhe kombëtare, në bazë të informacionit të marrë nga agjenci, biznese dhe ministri, si dhe nga të dhënat e punësimit të të diplomuarve. **[M3 stafi i lartë drejtues, politika 43 QA, 61 analiza programore, 61 analiza programore]** UMB gjithashtu bashkëpunon me institucione të arsimit të lartë në Shqipëri, Evropë e më gjerë. **[15 marrëveshje, 58 miratim programi, 59 miratimi i programit]** Këto bashkëpunime kontribuojnë në programet e studimit që ofron UMB-ja, duke siguruar që ato të pasqyrojnë prirjet aktuale kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të rrisin punësimin. **[M2 Ekipi i vetëvlerësimit, M5 stafi mësimdhënës]** Stafi akademik konfirmon se angazhimi me ish-studentët është i rëndësishëm për të siguruar që programet i pajisin studentët me aftësitë e nevojshme për punësim. **[M5 Stafi akademik; 31 Plani Strategjik i Zyrës së Alumnit dhe Karrierës; 28 Të dhëna për të diplomuarit]** Kjo u konfirmua më tej edhe nga punëdhënësit që kishin punuar ngushtë me Institucionin për të informuar dhe zhvilluar kurrikulën. **[M6 Punëdhënësit]** Shumë nga projektet e bashkërenduara nga institutet kërkimore sjellin informacion mbi tregun e punës që më pas përdoret për të përsosur më tej kurrikulat. **[41.1 Projekte dhe Aktivitete IPA, 41.2 Projekti dhe aktivitetet e IEB-së, 42 Projekti dhe Aktivitetet e BIRD-it]** Grupi i vlerësimit përgëzon punën e Institucionit me punëdhënësit, që siguron informacion në mënyrë konstruktive për zhvillimin e kurrikulës. **[Kapitulli I, Standardi I.4; ESG 1.2 Hartimi dhe miratimi i programeve]**
- 3.6 Organizimi i programeve në nivel universitar në module kryesore dhe dytësore mbështet një qasje të integruar të mësimdhënies dhe të nxëniet. Specialitetet e lëndëve mund të bashkohen duke pasqyruar fushat e interesit dhe për të mbështetur administrimin e mësimdhënies, kërkimit dhe rolet administrative të lektorëve individualë. **[1 Statuti; 3 Rregulloret akademike; M5 Stafi akademik]** Ngarkesat mësimore administrohen në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, dhe pasqyrohen në kontratat e punës. Stafi akademik ka mundësinë të marrë orë mësimi shtesë, nëse nuk ka angazhime të shumta kërkimore. **[RVV f. 29; Ngarkesa e punës për lektorët me kohë të plotë dhe të pjesshme; 44 Manuali i stafit; Stafi akademik M5; Kapitulli I, Standardi I.1]**
- 3.7 UMB-ja iu ofron studentëve informacion lehtësisht të kuptueshëm mbi programet e tij. **[45 dhe 46 Broshura; 47 Psikologji Bachelor; 48 Sociologji Bachelor]** Gjatë javës së parë të vitit akademik, lektorët iu ofrojnë studentëve programin mësimor të lëndës, përfshirë informacione të hollësishme mbi temat e kursit, vlerësimin dhe detyrat përkatëse. **[25 kurrikula, 26 plani i detajuar i kursit]** Objektivat e programeve të studimit përcaktohen në rregulloret e çdo programi studimi **[6 rregulloret e programeve Bachelor, 7 rregullore të programeve Master, 27 programe shembuj]** Përmbajtja e programeve të studimit, përfshirë orarin e orëve të mësimit, vihet në dispozicion të studentëve në faqen e internetit të UMB-së. **[RVV, demonstrim TI, studentë M4, Stafi mbështetës i M7]** Studentët raportuan se janë të kënaqur me informacionin e qartë dhe të mjaftueshëm të vënë në dispozicion nga stafi mësimdhënës dhe faqja në internet e Institucionit. **[Studentët M4; 02 Anketa e Studentëve]** UMB gjithashtu organizon një seancë orientimi, "Java e akomodimit", që prezanton studentët e rinj me Institucionin dhe studimet e tyre. Kjo ishte e mirëpritur nga studentët. **[SER p30, M4 Studentët, 16 Programi i Javës së Akomodimit]** Grupi i vlerësimit konfirmon zhvillimin e vazhdueshëm të sistemit të informacionit në internet, i cili rrit aksesin në informacione të besueshme të programit për studentët. **[Kapitulli I, Standardi I.6]**
- 3.8 Programet e studimeve të ciklit të parë u ofrojnë studentëve njohuri mbi lëndët, metodat dhe parimet e përgjithshme shkencore. **[6 rregullore e ciklit të parë, 24.2 Program BA, 26 plani i kursit, 27 shembuj programesh, 47 programe Bachelor, 48 programe Bachelor]** Programet e ciklit të parë dhe të dytë përfshijnë mundësi për kërkime dhe përvoja praktike. **[7 Rregullore e ciklit të dytë, 24.1 Kurrikula e masterit, 22 dosje praktike, 24 dosje praktike, 60 analiza e programit]** Studentët raportuan se ata kanë një mori mundësish për të marrë pjesë në projekte, kërkime dhe praktika, dhe ndihen të mbështetur mirë nga Institucioni. Ata e konsiderojnë të drejtë ekuilibrin midis teorisë dhe praktikës në programet e tyre, dhe e vlerësojnë informacionin e marrë për transferimin e studentëve, kreditet dhe përparimin. **[Studentët M4; 34 Rregullorja e brendshme për transferimin e studentëve; Kapitulli I, Standardi I.7 dhe Standardi I.11]**
- 3.9 Lëvizshmëria e stafit dhe studentëve konsiderohet me përparësi për UMB-në dhe programet e studimit janë hartuar për të mbështetur studentët që angazhohen në shkëmbime dhe veprimtari

me jashtë. Strukturat e programit që përfshijnë module të lëndëve kryesore dhe dytësore e mbështesin këtë lëvizshmëri. **[M1 Ekipi SER, M5 Stafi akademik]** UMB-ja përdor më së miri gamën e gjerë të bashkëpunimeve për stafin dhe shkëmbimin e studentëve, dhe përfshin në mënyrë proaktive studentët në projekte sa herë që është e mundur. **[Stafi i lartë drejtues M3, 15 lista e marrëveshjeve institucionale; 16 Lista e Aktiviteteve Ndërkombëtare; 17 Lista e Lëvizshmërisë; Kapitulli I, Standardi I.10]** Raportet e të dhënave të institucionit tregojnë një rritje të lëvizshmërisë së studentëve. Për studentët e ciklit të dytë shtohet kërkesa për të marrë një provim të pranuar ndërkombëtarisht në një nga gjuhët kryesore evropiane, si anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht ose italisht. **[8 Raport vjetor;]** Përmirësimi dhe larmia e metodave të mësimdhënies mbështetet nga institucioni, dhe studentët kanë mundësi të marrin pjesë në leksione të hapura, tryeza të rrumbullakëta dhe të takohen me përfaqësues të organizatave të jashtme. Mësimdhënia ofrohet nga personel i anëtarësuar në një nga institutet kërkimore të UMB-së. Mbi 70 për qind e stafit mësimdhënës janë punonjës me kohë të plotë. **[20 Lista e konferencave; 16 Lista e pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare; Ngarkesa e punës për stafin mësimdhënës me kohë të plotë dhe të pjesshme; Kapitulli I, Standardi I.8]** Të nxënit përmes praktikës është karakteristikë e një numri programesh universitare. Çdo student duhet të hartojë një "Dosje të praktikave" në mbështetje të arsimit dhe formimit profesional. **[22 dhe 23 Dosjet e praktikave; Kapitulli I, Standardi I.9]**

- 3.10 Për të ndihmuar në përgatitjen e studentëve për punësim, Institucioni ofron një numër të madh praktikash, vendosjesh dhe projektesh me organizata të jashtme, dhe ka marrëveshje të shumta që lehtësojnë këto procese. **[15 Marrëveshjet, M4 Takim me Studentët, M5 Takimi me stafin mësimdhënës, M6 Takimi me punëdhënësit]** Siç u theksua më lart, praktikat janë pjesë e shumë programeve studimore të ofruara nga Institucioni dhe studentët raportojnë se ato janë të dobishme dhe me vlerë. **[24 dhe 25 Përmbajtja e kurrikulës: 26 plani i kursit, 27 shembuj të programeve Master dhe Bachelor]** Studentët ndiheshin të mbështetur mirë në zhvillimin e aftësive dhe njohurive profesionale, **[M4 Takim me Studentët; 02 Pyetësor i studentëve]** dhe punëdhënësit raportojnë se studentët janë të përgatitur mirë dhe të motivuar. **[M6 Takimi me Punëdhënësit, 2 dhe 23 dosje praktike]** Grupi i vlerësimit e konsideron si praktikë të mirë menaxhimin e praktikave dhe vendosjen e studentëve si mënyrë efikase për të përkrahur zhvillimin e praktikës dhe njohurive bazuar në praktikë. **[Kapitulli 1 Standardi I.2]**
- 3.11 Menaxhimi dhe zhvillimi i kurrikulës së ofruar nga UMB-ja përmbush standardet e cilësisë. Institucioni ka sisteme të shëndosha për zhvillimin e kurrikulës dhe punon në mënyrë konstruktive me partnerët e jashtëm dhe punëdhënësit. Qasja ndaj të nxënit gjatë gjithë jetës përmes ofrimit të zhvillimit profesional dhe menaxhimit të praktikave që mbështesin studentët për të fituar njohuri bazuar në praktikë, përbëjnë praktika të mira. Puna e vazhdueshme me punëdhënësit për të mbledhur informacion për zhvillimin e kurrikulës dhe sistemeve të informimit në internet që iu japin studentëve informacion, u konfirmuan si efikase.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi praktikat e mira me karakteristikat e mëposhtme:

- Qasja e UMB-së ndaj të nxënit gjatë gjithë jetës, gjë që promovohet duke përfshirë në programet e studimit edhe module të lëndëve dytësore, për të siguruar zhvillimin e vazhdueshëm profesional (pika 3.4)
- Menaxhimi i praktikave dhe ofrimit të praktikave për studentët përkrah në mënyrë efikase zhvillimin e njohurive bazuar në praktikë (pika 3.10).

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë të dobësi në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk bëri asnjë rekomandim në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim në proces në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Vlerësim

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Mekanizma efikase zbatohen për menaxhimin e cilësinë dhe standardeve të mësimdhënies dhe kërkimit, me qëllim realizimin e standardeve të cilësisë. Shërbimi i UMB-së përshkruhet qartë në një sërë dokumentesh të printuara dhe elektronike në internet, të disponueshme përmes faqes së internetit dhe intranetit. **[25 Kurrikula, 26 Programe të detajuara të kurseve, 6 rregullore të programeve Bachelor , 7 rregullore të programeve Master, 27 programe shembull, M6a Demonstrim TI, M4 studentët, M7 Stafi mbështetës]** Departamentet, fakultetet dhe sekretarët akademikë hartojnë programe, plane semestrale dhe pyetje provimi për të siguruar dokumentimin e plotë të menaxhimit të programeve. **[1 Statuti; 3 Rregullore akademike; Stafi akademik M4; Staf mbështetës M7]** Programet e studimit janë objekt përmirësimi të vazhdueshëm përmes një procesi shqyrtimi vjetor, rishikim ky që është pjesë e rishikimit të secilit prej programeve. Rishikimi i programit përfshin shqyrtimin e studimit të tregut të punës, pikat e forta dhe të dobëta të shërbimit, mendimet e studentëve, zhvillimin e aftësive të transferueshme dhe marketingut. **[60 Shqyrtimi vjetor i programit; 61 Analiza e departamentit; 62 Analiza e punës për Fakultetin e Drejtësisë, Shkencave Sociale dhe Politike]** Këto rishikime më pas merren në shqyrtim nga departamenti, i cili analizon të gjitha aktivitetet kërkimore dhe mësimore, duke përfshirë performancën e studentëve. **[61 Shqyrtimi i departamentit]** Përfundimet e tyre përbëjnë bazën e rishikimit nga ana e fakultetit. **[62 Analiza e punës për Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe Politike]** Grupi i vlerësimit i çmon si praktikë të mirë sistemet e qarta dhe gjithëpërfshirëse për shqyrtimin vjetor të programeve dhe ndjekjen në vazhdimësi të veprimeve kryesore. **[Kapitulli I, Standardi II.1 dhe Standardi II.3; ESG 1.9 Monitorimi në vazhdimësi dhe rishikimi i programeve]**
- 4.2 Kërkesat dhe rregulloret e vlerësimit përcaktohen në statut dhe rregulloret akademike, në përputhje me standardet e cilësisë. **[1 Statuti i nenit 74; 3 Rregulloret akademike, nenet 49-56]** Pyetjet e provimit miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Rezultatet e provimeve dhe pasqyrat e arritjeve të studentëve ruhen nga sekretaria mësimore e fakultetit dhe u shpallen studentëve përmes një sistemi konfidencial në internet. **[M4 Stafi akademik; M7 Stafi mbështetës; 3 Rregulloret akademike]** Studentët kanë të drejtë të ankohen për rezultatet. Këto ankesa i drejtohen përgjegjësit të departamentit. **[5 Rregullorja e brendshme e Departamentit të Drejtësisë; Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë për drejtësi, [Kapitulli I, Standardi II.2]**
- 4.3 Përveç rishikimit vjetor të programeve të studimit, Institucioni përdor një sërë procedurash për vlerësimin dhe monitorimin e procesit të mësimdhënies. Këtu përfshihen vlerësimi nga ana e studentëve, vlerësimi i mësimdhënies, pyetësorët dhe analiza e performancës së studentëve. **[01SER fq.35, 40 Formularë pyetësori, 61 Shqyrtimi i Departamentit, 62 Rishikimi i Fakultetit, 43 Politika e SC, 64 Vëzhgimi i mësimdhënies]** Lektorët vëzhgohen nga grupe nga radhët e tyre dhe në fund jepen mendime mbi performancën e tyre. **[Kapitulli I, Standardi II.3]**
- 4.4 Vëzhgimi i mësimdhënies dhe inspektimi i dokumentacionit të kursit janë pjesë vlerësimit nga ana e stafit, që kryhet çdo vit. Ekipi i Sigurimit të Cilësisë së Brendshme vëzhgon mësimdhënien dhe përgatit një raport vlerësimi, mbi bazën e informacionit të mbledhur nga anketat, vëzhgimi i kolegëve dhe vëzhgimi i Shefit të Departamentit. **[64 Vëzhgimi i mësimdhënies]** Raportet më pas shqyrtohen nga përgjegjësi përkatës i Departamentit i cili përgatit një përmbledhje të vlerësimit dhe përcakton synimet për vitin e ardhshëm akademik. Kjo përmbledhje diskutohet me lektorët dhe nënshkruhet nga të dyja palët që do t'i përdorin të dhënat si pjesë e vlerësimit të kursit. **[M3 Stafi i lartë drejtues, 43 Politika SC-së, 64 Vëzhgimi i mësimdhënies; Kapitulli I, Standardi II.4]**
- 4.5 Dy javë para përfundimit të çdo semestri, Zyra për Sigurimin e Cilësisë dhe Standardeve në Studimet Bachelor anketon mendimet e studentëve mbi programet e tyre të studimit me anë të një pyetësori. Të dhënat më pas analizohen për secilin kurs dhe shqyrtohen nga Departamenti dhe Senati. **[40 Pyetësori, 65 Raporti vjetor mbi veprimtarinë, 11 Vendimet e Senatit, 43 Politika e SC, 62 Rishikimi i Fakultetit]** Studentët i thanë grupit të vlerësimit se kanë vërë re ndryshime në ofrimin e mësimdhënies si reagim ndaj mendimit të studentëve të dhënë përmes

pyetësorëve, dhe ata pranuan se zëri i tyre merret parasysh për të bërë ndryshime dhe përmirësime në ofrimin e mësimit dhe mësimdhënies. **[Studentët M4; Kapitulli I, Standardi II.4]**

- 4.6 Të dhënat e marra nga pyetësorët e studentëve kontribuojnë në vlerësimin e plotë të anëtarëve të stafit akademik dhe përdoren për të përshtatur veprimtaritë e trajnimit dhe zhvillimit për stafin akademik. **[M5 Stafi akademik, M3 Stafi i lartë drejtues, 62 Shqyrtimi i Fakultetit]** Stafi ka shumë mundësi për trajnimin dhe zhvillim, përfshirë orë të rregullta trajnimi të dhëna nga lektorë të brendshëm me përvojë, ose lektorë të ftuar nga universitetet vendase ose të huaja. **[19 Lista e aktiviteteve]** Çdo punonjës ka të drejtë të marrë deri në shtatë ditë pushimi të paguar për vit akademik për të marrë pjesë në konferenca, seminare dhe trajnime. Departamentet nxisin dhe mbështesin stafin e tyre për të zhvilluar aftësitë e tyre mësimore. **[M5 Stafi akademik, M3 Stafi i lartë drejtues, 1 Statut, 20 Seminare dhe Kurse, 68 Manuali i stafit]** Grupi i vlerësimit e çmon si praktikë të mirë qasjen sistematike të UMB-së për zhvillimin e stafit duke motivuar stafin për t'u angazhuar në trajnime dhe mundësi nga jashtë Institucionit. **[Kapitulli I, Standardi II.4]**
- 4.7 Ngarkesat e stafit mbahen nën vëzhgim. Mësimdhënia, puna kërkimore dhe përgjegjësitë administrative bashkërendohen sipas pozicionit të punës dhe përcaktohen nga drejtuesi i linjës. Ngarkesa mësimore bazohet në legjislacionin vendas dhe lidhet me titullin akademik dhe përvojën e lektorit. Mesatarja është rreth 300 orë në vit. **[37 ngarkesa e punës, 70 orë mësimore, 68 udhëzime për stafin; Kapitulli II Standardi I.1]**
- 4.8 UMB-ja përcakton çështjet e saj me përparësi kërkimore në planet dhe raportet vjetore. **[M3 Stafi i lartë drejtues, 9 Raporti i aktivitetit kërkimor; të dhënat institucionale; 03 Pyetësori i stafit]** Institucioni ka tre institute kërkimore që lehtësojnë bashkëpunimin midis departamenteve në punë kërkimore. **[M1 Ekipi SER; 2 Platforma e zhvillimit strategjik]** Këto institute janë: Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti", një qendër për kërkime ndërdisiplinore në fushën e zhvillimit ekonomik, shkencor, teknologjik, shoqëror dhe kulturor; **[42 Raporti BIRD-së, www.bird.edu.al]** Instituti Shqiptar për Çështje Publike, një qendër për kërkime në lidhje me demokracinë, mirëqeverisjen, zhvillimin socio-ekonomik dhe procesin e integritimit evropian; **[41.1 Raporti AIPA-s, www.aipa.al]** dhe Instituti i Edukimit Barleti (IEB), i cili përqendrohet në zhvillimin e arsimit, kurrikulave dhe risitë didaktike. **[41.2 Raporti IEB, www.education.umb.al]** Stafi anëtarësohet në një nga institutet kërkimore në përputhje me departamentin e tyre dhe specializimin e lëndës, dhe pritet të kryejë kërkime sipas nevojës. **[4 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë; M5 Stafi akademik]** Stafi bën kërkime individuale dhe i paraqet rezultatet minimalisht në një konferencë të UMB-së, boton dokumente në revistën "Gjeopolitika" të institucionit ose kryen kërkime në ekipe me stafin dhe studentë të tjerë. Këto kërkime rrisin dhe zhvillojnë bazën kërkimore e të njohurive të institutit kërkimor dhe mund informojnë më tej procesin mësimor dhe të nxënit, dhe këto rezultate botohen gjithashtu. **[71 Lista e punimeve shkencore të publikuara; 9 Raporti i kërkimeve shkencore dhe projekteve 2015; Kapitulli II Standardi I.1]**
- 4.9 Departamentet janë njësitë themelore të Institucionit dhe si të tilla luajnë rol të rëndësishëm në promovimin e veprimtarisë kërkimore të stafit të tyre. **[4 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë, 5 Rregullorja e Brendshme e Departamentit të Drejtësisë]** Departamentet vendosin mbi çështjet e tyre me përparësi kërkimore në bashkërendim me institutet kërkimore. **[SER fq37, 4 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë, 5 Rregullorja e Brendshme e Departamentit të Drejtësisë; Kapitulli II Standardi I.2]** UMB-ja nxit dhe ndihmon stafin të aplikojë për fonde të jashtme, zakonisht për projekte që lidhen me arsimin e studentëve, zhvillimin profesional të lektorëve ose projekte që trajtojnë çështje të rëndësishme për shoqërinë, si zhvillimi shoqëror, ekonomik, teknologjik dhe shoqëror, demokratizimi dhe mirëqeverisja; inovacioni në arsim. **[42 Raport BIRD-së, 41.1 Raporti AIPA-s, 41.2 Raporti i IEB-së; M6 Punëdhënësit; M7 Stafi mbështetës]** Institutet kërkimore kanë pasur sukses të konsiderueshëm në tërheqjen e fondeve të jashtme, duke marrë edhe çmime nga programet Tempus dhe Erasmus+. Përmes kuadrit Erasmus, UMB-ja bashkëpunon me universitete publike dhe private në Shqipëri dhe vende të tjera në Evropë dhe ka krijuar rrjete partnerësh në çështje që kanë të bëjnë me qeverisjen qendrore dhe vendore, biznesin, të drejtën dhe ekonominë. **[42 Raporti i BIRD-së, 41.1 Raporti AIPA-s, 41.2 Raporti IEB-së, 63 Raporti i kërkimit shkencor]** Fondet e Erasmus-it i kanë dhënë UMB-së mundësi

për të punuar përmes Katedrës Zhan Mone, e cila synon të promovojë përsosmërinë në mësimdhënie dhe kërkime shkencore në fushën e studimeve evropiane; si dhe me Katedrën e UNESCO-s për multikulturalizmin, dialogun ndërkulturor dhe të drejtat e njeriut në Ballkan. **[65 Raport i aktiviteteve, 15 Marrëveshjet]** IAL-ja bashkëpunon gjithashtu me një sërë agjencish dhe institucionesh shtetërore në lidhje me programet e veta të studimit. **[15 Lista e Marrëveshjeve]** Studentët dhe stafi kanë mundësi të marrin pjesë në projekte kërkimore. **[17 Raporti i lëvizshmërisë, studentët M4; Kapitulli II Standardi I.3 dhe Standardi I.4]**

- 4.10 Çështjet me përparësi në kërkim përcaktohen çdo vit nga UMB-ja. Synohet të punësohet staf i kualifikuar, me përvojë ndërkombëtare dhe kualifikime të përshtatshme për rolin e tyre. **[10 Lista e Stafit - Braingain Fulbright]** Pjesëtarëve individualë të stafit u caktohen orë kërkimore në ngarkesën e tyre të punës, **[68 Manuali i stafit]** dhe janë të detyruar të paraqesin punën e tyre çdo vit, në të paktën një konferencë të brendshme shkencore, ose të botojnë një artikull shkencor në një revistë të njohur, ose të angazhohen me projekte të jashtme dhe bashkëpunuese. **[35 bursa, 9 raporti vjetor, 63 raporti vjetor]** Stafi raportoi se kërkimi shërben si bazë informimi për mësimdhënien. **[M5 Stafi akademik]** Personeli mbështetet në lidhje me angazhimin në konferenca, organizime dhe risi shkencore përmes bashkëpunimeve, siç është programi Erasmus, i cili ofron mundësi pjesëmarrjeje në nisma më të gjera, përfshirë ato që lidhen me Katedrën Zhan Mone dhe të UNESCO-s. Rezultatet e punës kërkimore lidhen me nisma dhe studime të komunitetit dhe shoqërore. **[16 Lista e pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare; 42 Projekti BIRD]** Stafi mbështetet të udhëtojë dhe me kryerjen e udhëtimeve që lidhen me kërkime kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe shpenzimet mbulohen nga UMB-ja. **[M5 Stafi akademik; Stafi i lartë drejtues M3; 19 Lista e Aktiviteteve]** Studentët kanë mundësi të përfshihen në projekte kërkimore, sipas rastit, të cilat rrisin mundësitë e tyre për të nxënë. **[Studentët M4; 8 Raporti Vjetor 2014-15]** UMB-ja ka një sistem informacioni në linjë për veprimtaritë e kërkimit dhe botimet e stafit. Çdo vit, departamentet hartojnë listën e aktiviteteve dhe botimeve të tyre shkencore. **[9 Raport vjetor, 63 Raport vjetor, 71 Publikime]** Grupi i vlerësimit e çmon si praktikë të mirë mbështetjen gjithëpërfshirëse që i ofrohet stafit akademik për të lehtësuar përfshirjen në projekte me financim nga jashtë dhe përfshirjen e studentëve në aktivitetet e lidhura me to. **[Kapitulli II Standardi II.5 dhe Standardi II.6]**
- 4.11 IAL-ja thekson nevojën për të botuar rezultatet e kërkimit dhe për të rritur pjesëmarrjen e tij në konferenca, seminare dhe median në internet. **[RVV f. 38; 1 Statuti; 20 Lista e konferencave, seminareve]** E drejta e autorit mbrohet në përputhje me legjislacionin. Stafi inkurajohet të botojë punimet e veta në revista të mirënjohura ndërkombëtare. Shtëpia botuese Dudaj është në pronësi të aksionarëve të UMB-së dhe stafi nxitet të botojë libra që mbështesin mësimdhënien. Çdo vit, departamentet hartojnë një listë të aktiviteteve kërkimore, të cilat përbëjnë bazë për rishikimin vjetor institucional dhe vlerësimin e aktiviteteve kërkimore. **[71 Lista e punimeve shkencore të botuar në vitin 2015-16; 9 Raport i kërkimeve shkencore dhe projekteve 2014-15; Stafi i lartë drejtues M3; Stafi akademik M5; Kapitulli II Standardi I.7 dhe Standardi I.8]**
- 4.12 Mësimdhënia, të nxënit, vlerësimi dhe kërkimi administrohen në mënyrë efikase nga UMB-ja. Studentët konfirmuan mbështetjen mjaft mirë dhe se kanë akses në informacionin e duhur. Institucioni kryen shqyrtime vjetore gjithëpërfshirëse, harton plane veprimi dhe zbaton një qasje sistematike për zhvillimin e stafit, që përfaqësojnë një praktikë të mirë. Mbështetja e stafit për t'u angazhuar në projekte me financim të jashtëm, dhe përfshirja e studentëve në projekte, ndihmon në zhvillimin e stafit dhe studentëve dhe gjithashtu u identifikua si një praktikë e mirë.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi praktikatat e mira me karakteristikat e mëposhtme:

- Sisteme të qarta dhe gjithëpërfshirëse për rishikimin vjetor të programeve dhe ndjekjen e veprimeve kryesore (pika 4.1)
- Qasja sistematike e UMB-së për zhvillimin e stafit motivon stafin për t'u angazhuar në trajnime dhe mundësi të jashtme (pika 4.6)

- Mbështetja gjithëpërfshirëse që i ofrohet stafit akademik për të lehtësuar përfshirjen në projekte me financim të jashtëm dhe përfshirja e studentëve në aktivitete të lidhura me to (pika 4.10)

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë të dobësi në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk bëri asnjë rekomandim në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim në proces në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Vlerësim

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Institucioni ka mekanizma që mbështesin studentët në të gjitha fazat e angazhimit të tyre me Institucionin. Pranimi i studentëve në programet universitare administrohet në përputhje me rregulloret e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[M2 Rektori; Raporti i Vetëvlerësimit]** Kërkesat e pranimit janë të përcaktuara qartë në Politikën e Pranimeve të UMB-së, **[3 Rregulloret akademike; 36 Politika e pranimit; M7 Stafi mbështetës]** e cila përfshin si pranimet në programet universitare ashtu edhe ato pasuniversitare. Faqja e internetit ofron informacion për studentët e ardhshëm dhe palët e tjera të interesit. **[Studentët M4; M7 Stafi mbështetës; faqja në internet dhe M6a Demonstrim TI]** Sistemet e zhvilluara rishtazi i mundësojnë UMB-së të monitorojë nivelet e interesit në programe individuale, përfshirë nivelin e veprimtarisë në kuadrin e informacionit të faqes në internet, aplikacionet dhe vizitat e kampusit. **[M6a Demonstrim TI; M7 Stafi mbështetës; M4 Studentët]** Të dhënat e mbledhura së bashku me rezultatet e anketimeve të studentëve përbëjnë bazë informimi për marketingun dhe komunikimet me jashtë; gjithashtu ndihmojnë nivelin e lartë drejtues të identifikojë nevojën për çdo informacion të mëtejshëm që kërkohet nga studentët. **[M7 Stafi mbështetës; 8 Raporti Vjetor; 36 Politika e Pranimeve; Kapitulli I, Standardi III.1; ESG 1.7 Menaxhimi i Informacionit]**
- 5.2 Kriteret e pranimit që zbatohen për kurset e shkurtra dhe studimet pasuniversitare miratohen nga Senati dhe menaxhohen nga Zyra e Rektorit. **[11 Lista e takimeve të Senatit; 13 Lista e vendimeve të Rektorit; M7 Stafi mbështetës]** Dhënia e shërbimeve që kombinojnë module të lëndëve kryesore dhe dytësore është tërheqëse për bizneset; dhe Institucioni po punon me punëdhënësit dhe profesionistët vendas për të identifikuar programe që mbështesin zhvillimin e vazhdueshëm profesional. **[M6 Partnerët e jashtëm; Stafi akademik M5; 2 Plani Strategjik 2020; 42 Projekti BIRD; Kapitulli I, Standardi III.1]**
- 5.3 UMB-ja ka një plan vjetor të qartë dhe efikas të veprimtarive që mbështesin rekrutimin e studentëve. Procesi i pranimit përbëhet nga tre elementë kryesorë: matja e nivelit të interesit të studentëve përmes monitorimit të interesit të treguar në faqen në internet dhe kërkesa; sasia e aplikimeve të plotësuara, të paraqitura në Zyrën e Pranimeve dhe Rekrutimit, dhe procesi i pranimit, përfshirë intervistat dhe takimet me studentët. Zyra e Rekrutimit dhe Pranimeve ruan dosje për të gjitha aplikimet dhe pranimet. **[36 Politika e Pranimeve; M7 Takimi me Partnerët e jashtëm; 45 dhe 46 Broshura; 36 Politika e pranimit; M7 Stafi mbështetës]** Zyra e Rekrutimit dhe Pranimeve punon ngushtë me Dekanin për Studentët, dhe është përgjegjëse për përgatitjen e veprimtarive të rekrutimit dhe orientimit të studentëve. **[M7 Stafi mbështetës; 1 Statuti; 37 Politika e Pranimeve]** Ato përfshijnë Ditët e Hapura, leksione, broshura, informacione në internet, kurse falas për të përgatitur nxënësit e shkollave të mesme për provimet e maturës shtetërore, dhe vizitat në shkollat e mesme. **[8 Raport Vjetor; 36 Politika e pranimit; M7 Stafi mbështetës; M4 Studentët]** Studentët konfirmuan se informacioni i dhënë është i dobishëm. **[Studentët M4; M7 Stafi mbështetës; 02 Përgjigjet e pyetësorit të studentëve; Kapitulli I, Standardi III.2 dhe Standardi III.3]**
- 5.4 Institucioni ka një politikë të qartë dhe gjithëpërfshirëse të mbështetjes së studentëve nga grupet e identikuara. Këtu përfshihen studentë nga pakicat etnike, zonat në vështirësi, jetimë ose ata me prindër të gjymtuar gjatë shërbimit për vendin, si dhe studentë të talentuar. **[36 Politika e Pranimeve; 8 Raporti Vjetor]** Studentët nga grupet e identikuara kanë të drejtë të marrin bursa të plota ose të pjesshme. **[19 Lista e Aktiviteteve; 35 Lista e bursave]** Disa zona në kampusin e dytë janë të përshtatshme për aksesin e studentëve me aftësi të kufizuara fizike. Në një sërë fushash programore, përfshirë shkencat sociale, financën dhe menaxhimin e biznesit, ofrohen mundësi studimi me kohë të pjesshme. Ky shërbim ofron mundësi për të nxënë gjatë gjithë jetës për ata që janë në marrëdhënie pune, ose që kanë nevojë të punojnë gjatë studimit. **[8 Raporti Vjetor; Studentët M4; 8 Raporti Vjetor; Kapitulli I, Standardi III.4]**
- 5.5 UMB-ja ka një proces të mirëorganizuar për orientimin dhe integrimin e studentëve të rinj. Java e aktiviteteve të orientimit ndihmon studentët të marrin informacion rreth rregulloreve, përmbajtjes së programeve dhe mundësive më të gjera shoqërore dhe akademike që ofrohen. **[69 Programi i Javës së Akomodimit; Studentët M4; M7 Stafi mbështetës; 02 Pyetësori i studentëve]** Gjithashtu, studentët kanë mundësi të marrin informacion shtesë nga Zyra për

- Orientimin Akademik, sekretaret dhe Dekani i Studentëve. **[Studentët M4; M7 Stafi mbështetës]** Programi i qartë i orientimit mbështet studentët për të kuptuar gamën e udhëzimeve dhe këshillave në dispozicion të tyre, dhe përfaqëson **praktikë të mirë**. Zyra për Orientimin Akademik është gjithashtu përgjegjëse për ofrimin e këshillave mbi mundësitë e studimit dhe progresin e studimeve të larta, së bashku me informacionin mbi transferimin. **[27 Programe Studimi; 34 Rregullorja e Brendshme e Transferimit; Kapitulli III Standardi III.3]**
- 5.6 Studentëve iu ofrohet mbështetje në një nivel të kënaqshëm. Përmes intranetit, studentët kanë akses në informacione të detajuara të programit, së bashku me shënime të leksioneve dhe materiale kursi. **[Studentët M4; 71 Lista e punimeve shkencore të botuara 2015 - 16; 49 Intraneti; 02 Pyetësi i studentëve]** UMB-ja vepron në përputhje me raportin ligjor staf - student, për të siguruar mbështetje të mjaftueshme akademike. **[1 Statuti; 11 Lista e Vendimeve të Senatit; M3 Stafi i lartë drejtues]** Për të gjithë studentët ofrohen udhëzime mbi programin. Për studentët me kërkesa që kanë nevojë për mbështetje shtesë, ofrohen mësim të veçanta dhe paketa mbështetëse, të cilat miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Rektori. **[13 Vendimet e Rektorit; 26 Orari i kursit; Stafi akademik M5; Kapitulli I, Standardi III.6; ESG 1.3 Të nxënit me në fokus studentin]**
- 5.7 Bibliotekat gjenden në çdo kampus duke siguruar qasje në tekste kyçe, ku shumica janë në formë elektronike dhe të lexueshëm gjatë orëve normale të punës. Studentët gjithashtu kanë akses në bibliotekat në internet, si për shembull Biblioteka e Oregonit në SHBA, të cilat ofrojnë materiale në gjuhë të tjera. **[M4 Stafi akademik; 15 Marrëveshje dhe Memorandume; Stafi i lartë drejtues M3; Raporti i 01 SE]** Bibliotekat pasurohen me tekste të reja në bazë të kërkesave të departamenteve dhe i nënshtrohen kufizimeve buxhetore. **[51 Pasqyrat buxhetore / financiare; 74 evidenca shtesë; Stafi i lartë drejtues M3; M7 Stafi mbështetës]** Studentët mund të lexojnë tekstet e bibliotekës në formë elektronike vetëm brenda kampusit, siç u diskutua në Fushën 2: Burimet. Zhvillimi i mëtejshëm i sistemeve në internet për të lejuar akses në distancë do të rriste mundësitë e studentëve për të studiuar. UMB-ja zbaton gjithashtu procedura të rrepta kundër plagjiaturës dhe shkeljes së të drejtave të autorit. **[3 Rregulloret akademike; Stafi i lartë drejtues M3; 15 Lista e Marrëveshjeve; 3 Rregulloret akademike; Kapitulli I, Standardi III.5]**
- 5.8 Studentët mund të japin mendimet e tyre për UMB-në përmes anketimeve, diskutimeve me mentorët, përfaqësuesit të zgjedhur të studentëve në Senat, në mbledhjet e fakulteteve, si dhe përmes takimeve formale dhe joformale me mentorët. Të gjitha mendimet e studentëve përbëjnë bazë për rishikimet vjetore. Unioni i Studentëve, i përbërë nga përfaqësues të studentëve të zgjedhur nga radhët e tyre çdo vit, jep gjithashtu mendime në emër të trupës studentore. **[40 Formular pyetësorësh; Pyetësi i studentëve; Studentët M4; M5 Stafi akademik]** Studentët konfirmuan se janë këshilluar për burimet, zhvillimet e kampusit dhe nismat e tjera, përfshirë pjesëmarrjen në projekte me jashtë dhe kërkimore. **[65 Raport mbi Aktivitetin Institucional; Studentët M4; Pyetësi i studentëve; M7 Stafi mbështetës]** Këshillimi me studentët për të mbledhur informacion për rishikimet vjetore, zhvillimin e ambienteve dhe përmirësimet u çmua si **praktikë e mirë**. Zyra e Dekanit të Studentëve është përgjegjëse për ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes kur identifikohen probleme të studentëve. **[3. Rregullorja Akademike; M7 Stafi mbështetës; Studentët M4; Pyetësi i Studentit; Kapitulli I, Standardi II.7]**
- 5.9 Studentët mund të komunikojnë me stafin akademik përmes sistemit të adresave elektronike të UMB dhe faqeve të mentorëve në intranet, përmes forumeve për të mbështetur punën në grup ose komunikime më të gjera që lidhen me studimet dhe aktivitetet shoqërore, por ata nuk mundën akoma të komunikojnë me njëri-tjetrin përmes këtij sistemi. **[M6a Demonstrim TI; Studentët M4; 49 Intraneti]** Zhvillimi i vazhdueshëm i sistemeve në internet duke mbështetur më tej komunikimin e studentëve do të përmirësonte më tej shërbimin. **[Kapitulli I, Standardi III.3]**
- 5.10 Institucioni u ofron studentëve akses në një numër aktivitetesh sportive dhe shoqërore, duke përfshirë një kampionat volejboli, një ekip futbollit, klube studentore dhe organizime shoqërore. **[32 Zyra e vetorganizimit të studentëve; Lista e trajnimit të studentëve; M4 Studentët]** Zyra për Çështjet e Studentëve dhe Zyra e Ish Studentëve dhe Karrierës ofrojnë këshilla

financiare dhe karriere. **[32 Klube Studentësh; 1 Statuti UMB; 31 Zyra e Alumnit dhe Karrierës]** Studentët raportojnë se ata kanë mundësi të angazhohen me një gamë të gjerë veprimtarish, përfshirë konferencat dhe nismat e bashkëpunimit në lidhje me projekte me financim të jashtëm, gjë që zhvillon përvojën e tyre të të nxënit. **[32 Plani i vetorganizimit të zyrës së studentëve; 33 Lista e trajnimeve të studentëve; M4 Studentët]** Larmia e klubeve dhe veprimtarive në dispozicion të studentëve, përfshirë organizimet sportive, kulturore dhe akademike, si dhe botimin nga ana e UMB-së të Revistës "Zëri i Studentit" të shkruar nga studentë, përmirësojnë përvojën e të nxënit dhe nxisin angazhimin e studentëve. Këto përbëjnë një **praktikë të mirë**. **[Kapitulli I, Standardi III.8]**

5.11 Zyra e Ish Studentëve dhe Karrierës (ZISK) ruan një listë përgjithshme të të diplomuarve dhe të dhënave për punësimin e tyre, e cila përditësohet çdo vit. Statistikat tregojnë se punësimi i të diplomuarve është rreth 80 për qind. **[28 Të dhënat ish-studentëve, të diplomuarit e punësuar; M7 Staf mbështetës]** ZISK-u ofron ndihmë për studentët në vitin e fundit të studimeve përmes mbështetjes me aftësi për kërkimin e punës, karrierës dhe orientime. **[31 Zyra e Ish Studentëve dhe Karrierës; 33 Lista e trajnimit të studentëve; M7 Takim me staf mbështetës]** Puna e ZISK-ut duke ndjekur të diplomuarit që mund të mos kenë gjetur punë dhe duke vazhduar t'i mbështesë ata me njoftime për vende të lira pune, këshilla dhe udhëzime u çmua si **praktikë e mirë**. **[31 Zyra e Alumnit dhe Karrierës; 33 Lista e trajnimit të studentëve; Staf mbështetës; M4 Studentët]** Marrëveshjet formale me punëdhënësit dhe studentët ndihmojnë studentët të gjetur vendosje për të marrë përvojë praktike. **[15 Lista e marrëveshjeve; 31 Plani Strategjik i Zyrës së Alumnit dhe Karrierës; M6 Partnerët e jashtëm; M4 Studentët]** Përveç kësaj, informacioni për panairët e punësimit dhe vendet e lira të punës i njoftohen Institucionit përmes rrjetit të punëdhënësve dhe studentëve të tij. **[33 Lista e Trajnimit Profesional dhe Punësimit; 28 Baza e të dhënave të të diplomuarve]** Rrjeti efikas i punëdhënësve dhe i të diplomuarve, siç u theksua në pikën 3.10, mbështet me efikasitet praktikat dhe vendosjet në praktikë të studentëve. **[Kapitulli I, Standardi III.8]**

5.12 Institucioni i përmbush standardet për "Studentët dhe mbështetjen e tyre". Për të mbështetur orientimin e studentëve zbatohen mekanizma efikase, përfshirë sigurimin e informacionit dhe udhëzimeve të qarta, pritshmëritë e të nxënit dhe mbështetja nga mentorët. Mbështetja që ofron Zyra e Ish të Diplomuarve dhe Karrierës në gjetjen e punës pas diplomimit, përdorimi i mendimit të studentëve si bazë për zhvillimin dhe larminë e aktiviteteve jashtëshkollore, përbëjnë praktika të mira. Institucioni zbaton strategji për të vazhduar zgjerimin e burimeve të bibliotekës dhe për ofrimin e mekanizmave që mbështesin komunikimet në grup.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi praktikat e mira me karakteristikat e mëposhtme:

- Programi i qartë i orientimit ndihmon studentët për të kuptuar gamën e udhëzimeve dhe këshillave në dispozicion (pika 5.5)
- Këshillimi me studentët shërben si informacion bazë për rishikimin dhe përmirësimet vjetore (pika 5.8)
- Gama e klubeve dhe veprimtarive në dispozicion të studentëve, përfshirë aktivitetet sportive, kulturore dhe akademike, rrisin përvojën e të nxënit tek studentët (pika 5.10)
- Zyra e Ish të Diplomuarve dhe Karrierës ndjek ish-studentët që mund të mos kenë gjetur punë dhe vazhdon t'i mbështesë ata me njoftime për vende të lira pune, këshilla dhe udhëzime (pika 5.11).

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë të dobësi në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk bëri asnjë rekomandim në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim në proces në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Vlerësim

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.